



# **FLETORJA ZYRTARE**

## **E**

# **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**Nr.9**

**2004**

**3 mars**

### **P Ë R M B A J T J A**

Faqe

Ligj nr.9171  
datë 22.1.2004

Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të  
Republikës së Shqipërisë ..... 365

Udhëzim i MTT  
nr.5781, datë 23.12.2003

Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes  
së licencave, lejeve, certifikatave dhe autorizimeve për  
ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor..... 378

**L I G J**  
**Nr.9171, datë 22.1.2004**

**PËR GRADAT DHE KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA**  
**TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Ky ligj përcakton: kriteret dhe autoritetin për pranimin në Forcat e Armatosura, rendin e gradave, përparimin në gradë dhe në karrierë, përgjegjësitë që rrjedhin nga karakteri i veçantë i detyrës dhe i shërbimit ushtarak dhe ndërprerjen e karrierës për ushtarakët e Forcave të Armatosura.

**Neni 2**

1. Gradat ushtarake janë tituj e shenja dalluese në emërtesën e hierarkisë ushtarake.
2. Hierarkia ushtarake përfshin rendin e gradave dhe të funksioneve.
3. Rendi i gradave dhe i funksioneve në Forcat e Armatosura shkallëzohet nga më e ulëta në më të lartën, sipas lidhjeve e varësive që kanë ndërmjet tyre.
4. Ushtarakët, në varësi nga vendi i tyre në hierarkinë e gradave, kanë veçoritë e më të lartit dhe më të ulët.

**Neni 3**

Karriera ushtarake është rendi i përgjegjësive të ushtarakut gjatë kohës që shërben në Forcat e Armatosura, sipas arsimimit, kualifikimit, aftësive drejtuese e profesionale dhe vjetërsisë së shërbimit.

**Neni 4**

1. Në hierarkinë ushtarake, ushtarakët janë oficerë, nënoficerë dhe ushtarë (detarë).
2. Ushtarakët e Forcave të Armatosura janë ushtarakë të shërbimit aktiv të përhershëm (të karrierës), të shërbimit aktiv të përkohshëm, të shërbimit aktiv të detyrueshëm, si dhe ushtarakë të rezervës.

**Neni 5**

1. Në kuptim të këtij ligji:
  - a) “Oficer aktiv i Forcave të Armatosura” është shtetasi shqiptar që ka kryer arsimin e lartë ushtarak brenda ose jashtë vendit ose shtetasi shqiptar që ka kryer arsimin e lartë civil dhe kursin përkatës ushtarak, jo më pak se një vit në Akademinë Ushtarake, që bën betimin ushtarak dhe titullohet si i tillë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

b) “Oficer në rezervë i Forcave të Armatosura” është shtetasi shqiptar që ka kryer arsimin e lartë dhe në raste të veçanta arsimin e mesëm, ka kryer kualifikimin e nevojshëm ushtarak për specialitetin përkatës, që ka bërë betimin ushtarak dhe është titulluar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Të tillë janë dhe oficerët aktivë të Forcave të Armatosura që dalin në rezervë.

c) “Nënoficer aktiv i Forcave të Armatosura” është shtetasi shqiptar që ka kryer arsimin e mesëm ose arsimin e lartë, kualifikimin përkatës të nënoficerit, që ka bërë betimin ushtarak dhe është titulluar si i tillë me urdhër të komandantit të forcës ose të komandës mbështetëse.

ç) “Nënoficer në rezervë i Forcave të Armatosura” është shtetasi shqiptar që ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, arsimin e mesëm, kualifikimin përkatës dhe është titulluar si i tillë nga komandanti i forcës ose komandës mbështetëse.

d) “Ushtar/detar i shërbimit të detyrueshëm aktiv/rezervë i Forcave të Armatosura” është shtetasi shqiptar që kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv/rezervë sipas ligjit dhe bën betimin ushtarak.

dh) “Ushtar/detar profesionist” është shtetasi shqiptar që ka kryer arsimin e mesëm ose të lartë, shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose kursin profesional përkatës (stërvitja bazë) dhe titullohet si i tillë me urdhër të komandantit të forcës ose të komandës mbështetëse, si dhe bën betimin ushtarak. Ministri i Mbrojtjes, me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përcakton me akt nënligjor procedurat, përgjegjësitë dhe mënyrat e rekrutimit të ushtarëve profesionistë.

2. Oficer, nënoficer dhe ushtar aktiv me pagesë në Forcat e Armatosura pranohet shtetasi shqiptar që, përveç kriterëve të përcaktuara në pikën 1 shkronjat “a”, “c”, “d” dhe “dh” të këtij neni, është në moshën 19 deri në 30 vjeç.

3. Në shërbimin ushtarak si oficer, nënoficer, ushtar me pagesë nuk pranohen shtetasit që janë dënuar nga gjykata për vepër penale, për të cilën dënimi minimal është deri në 1 vit, që kanë humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit ose të veprimtarisë në administratën publike me vendim gjykatë dhe që ndodhen në një proces hetimor me masë sigurie.

## Neni 6

Ushtarakët, me futjen e tyre në shërbimin ushtarak, nënshkruajnë kontratë në këto raste:

1. Për ushtarët me pagesë/profesionistë:

a) kontrata lidhet për një afat jo më pak se 3 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës përcaktohet me urdhër të komandantit të forcës ose komandës mbështetëse, por jo më e gjatë se afati fillestar;

b) kontrata nënshkruhet ndërmjet shtetasit dhe komandantit të forcës ose komandës mbështetëse.

2. Për nënoficerët:

a) kontrata e parë nënshkruhet për një afat jo më pak se 6 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës përcaktohet me urdhër të komandantit të forcës ose komandës mbështetëse, por jo më e gjatë se afati fillestar;

b) kontrata nënshkruhet ndërmjet shtetasit dhe komandantit të forcës ose komandës mbështetëse;

c) nënoficerët duhet të kenë plotësuar kriteret e arsimit ushtarak për gradën që kanë, në mënyrë që të përmbushin kërkesat për të rinovuar kontratën në po atë gradë.

3. Për oficerët:

a) kontrata nënshkruhet me fillimin e studimeve në shkollat e larta ushtarake (brenda dhe jashtë vendit). Në kontratë përfshihet koha e arsimimit dhe 6 vjet shërbimi në Forcat e Armatosura, me të drejtë ripërtëritjeje edhe deri 6 vjet të tjera;

b) kontrata nënshkruhet ndërmjet shtetasit, komandantit të akademisë ushtarake dhe përfaqësuesit të Ministrit të Mbrojtjes (për studentët dhe oficerët);

c) në rast shkeljeje të kontratës, ushtarakët detyrohen të dëmshpërblejnë shpenzimet për kohën e studimit (kualifikimit) brenda ose jashtë vendit. Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes për shlyerjen e detyrimit në këto raste përbën titull ekzekutiv.

## KREU II GRADAT USHTARAKE

### Neni 7

Në Forcat e Armatosura grada u jepen oficerëve e nënoficerëve të shërbimit aktiv dhe rezervë, ushtarëve/detarëve të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe rezervë, si dhe ushtarëve me pagesë/profesionistë.

### Neni 8

Gradat ushtarake në Forcat e Armatosura për oficerët klasifikohen në grada të ulëta, grada të larta dhe grada madhore.

### Neni 9

Gradat ushtarake, sipas titullit, shërbimit dhe llojit të gradës, janë:

1. Për ushtarakët e titulluar oficer aktiv:

| Niveli i titullit | Forcat tokësore/ajrore<br>Lloji i gradës | Forcat detare<br>Lloji i gradës |
|-------------------|------------------------------------------|---------------------------------|
| Gradë madhore     | Gjeneral                                 | Admiral                         |
| Gradë madhore     | Leitnant                                 | Nënadmiral                      |
| Gradë madhore     | Gjeneral Major                           | Kundëradmiral                   |
| Gradë madhore     | Gjeneral Brigade                         |                                 |
| Gradë e lartë     | Kolonel                                  | Kapiten i Rangut I              |
| Gradë e lartë     | Nënkolonel                               | Kapiten i Rangut II             |
| Gradë e lartë     | Major                                    | Kapiten i Rangut III            |
| Gradë e ulët      | Kapiten                                  | Kapiten Leitnant                |
| Gradë e ulët      | Toger                                    | Leitnant                        |
| Gradë e ulët      | Nëntoger                                 | Nënleitnant                     |

2. Për ushtarakët e titulluar nënoficer:

| Niveli i titullit | Forcat tokësore/ajrore<br>Lloji i gradës | Forcat detare<br>Lloji i gradës |
|-------------------|------------------------------------------|---------------------------------|
| Nënoficer         | Kryekapter                               | Kryekapter                      |
| Nënoficer         | Kapter                                   | Kapter                          |
| Nënoficer         | Rreshter                                 | Rreshter                        |
| Nënoficer         | Tetar                                    | Tetar                           |
| Nënoficer         | Nëntetar                                 | Nëntetar                        |

### 3. Për ushtarakët e titulluar ushtar:

| Niveli i titullit | Forcat tokësore/ajrore<br>Lloji i gradës | Forcat detare<br>Lloji i gradës |
|-------------------|------------------------------------------|---------------------------------|
| Ushtar            | Ushtar profesionist II                   | Detar profesionist II           |
| Ushtar            | Ushtar profesionist I                    | Detar profesionist I            |
| Ushtar            | Rekrut II                                | DetarII                         |
| Ushtar            | Rekrut I                                 | Detar I                         |

### 4. Gradat ushtarake për studentët:

| Klasa   | Viti akademik | Lloji i gradës |
|---------|---------------|----------------|
| student | viti IV       | klasi i katërt |
| student | viti III      | klasi i tretë  |
| student | viti II       | klasi i dytë   |
| student | viti I        | klasi i parë   |

a) për studentët e diplomuar në universitete, lloji i gradës është kandidat për oficer;

b) për studentët që ndjekin akademinë e nënoficerëve, lloji i gradës është kandidat për nënoficer;

c) studentët shqiptarë që ndjekin studimet në shkollat e huaja ushtarake, mbajnë uniformën dhe simbolet e gradës së studentit të akademive ushtarake shqiptare, sipas marrëveshjeve dypalëshe me vendet pritëse;

ç) rekrutët e rinj dhe ushtarët profesionistë, kur hyjnë në shërbimin aktiv, nuk mbajnë gradë, por quhen rekrutë deri në përfundimin me sukses të stërvitjes bazë. Pas përfundimit të kësaj periudhe, rekrutët gradohen rekrut I ose detar I, ndërsa rekrutët ushtarë profesionistë, gradohen ushtar profesionist I.

## Neni 10

Koha minimale e qëndrimit në një gradë, për fitimin e gradës pasardhëse është:

| Titulli i gradës<br>Forcat tokësore/ajrore | Titulli i gradës<br>Forcat detare | Koha në gradë   |
|--------------------------------------------|-----------------------------------|-----------------|
| Rekrut I                                   | Detar                             | I¼ vit (3 muaj) |
| Rekrut II                                  | Detar II                          | ¾ vit (9 muaj)  |
| Ushtar PR I                                | Detar PR I                        | 1 vit           |
| Ushtar PR II                               | Detar PR II                       | 1 vit           |
| Nëntetar                                   | Nëntetar                          | 4 vjet          |
| Tetar                                      | Tetar                             | 4 vjet          |
| Rreshter                                   | Rreshter                          | 5 vjet          |
| Kapter                                     | Kapter                            | 5 vjet          |
| Nëntoger                                   | Nënleitnant                       | 3 vjet          |
| Toger                                      | Leitnant                          | 4 vjet          |
| Kapiten                                    | Kapiten leitnant                  | 5 vjet          |
| Major                                      | Kapiten i rangut III              | 4 vjet          |
| Nënkolonel                                 | Kapiten i rangut II               | 5 vjet          |
| Kolonel                                    | Kapiten i rangut                  | 14 vjet         |
| Gjeneral brigade                           | Kundëradmiral                     | 3 vjet          |
| Gjeneral major                             | Nënadmiral                        | 3 vjet          |

a) koha në gradë në shërbimin aktiv/rezervë llogaritet nga data e nxjerrjes së urdhrit përkatës;

b) koha e shërbimit në rezervë nuk llogaritet për minimumin e kohës së qëndrimit në gradë që duhet për gradim në shërbimin aktiv;

c) kriteret për gradimin e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve rezervistë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 11

Koha maksimale e qëndrimit në shërbim në një gradë është:

| Titulli i gradës<br>Forcat tokësore/ajrore | Titulli i gradës<br>Forcat detare | Koha në shërbim aktiv |
|--------------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------|
| Rekrut I                                   | Detar I                           | ½ vit                 |
| Rekrut II                                  | Detar II                          | 1 vit                 |
| Ushtar PR I                                | Detar PR                          | 16 vjet               |
| Ushtar PR II                               | Detar PR II                       | 6 vjet                |
| Nëntetar                                   | Nëntetar                          | 12 vjet               |
| Tetar                                      | Tetar                             | 20 vjet               |
| Rreshter                                   | Rreshter                          | 22 vjet               |
| Kapter                                     | Kapter                            | 27 vjet               |
| Kryekapter                                 | Kryekapter                        | 30 vjet               |
| Nëntoger                                   | Nënleitnant                       | 6 vjet                |
| Toger                                      | Leitnant                          | 8 vjet                |
| Kapiten                                    | Kapiten leitnant                  | 15 vjet               |
| Major                                      | Kapiten i rangut III              | 22 vjet               |
| Nënkolonel                                 | Kapiten i rangut II               | 27 vjet               |
| Kolonel                                    | Kapiten i rangut I                | 30 vjet               |
| Gjeneral brigade                           | Kundëradmiral                     | 33 vjet               |
| Gjeneral major                             | Nënadmiral                        | 35 vjet               |
| Gjeneral leitnant                          | Admiral                           | 35 vjet               |

a) ushtaraku, i cili ka plotësuar afatin maksimal të shërbimit në një gradë dhe nuk ka marrë gradën e radhës, del në rezervë/lirim;

b) oficerëve dhe nënoficerëve, që kanë 12 vjet shërbim, me kërkesën e tyre, u lind e drejta të kalojnë profesionistë, në varësi të nevojave të Forcave të Armatosura dhe sipas të kualifikimit përkatës.

### KREU III

#### KARRIERA USHTARAKE, KRITERET DHE MËNYRA E GRADIMIT

#### Neni 12

1. Gradat për ushtarët jepen nga komandanti i njësisë (brigadë, regjiment) dhe i reparteve të njësuara me të.

2. Gradat e nënoficerëve aktivë e rezervistë jepen nga komandanti i forcës dhe nga komandantët e njësisë të varësisë së Shtabit të Përgjithshëm, sipas kriterëve të përcaktuara.

3. Kursantët, që përfundojnë kurset pranë Akademisë së Nënoficerëve, titullohen nënoficerë dhe u jepet grada nëntetar. Të drejtën e propozimit për titullimin e nënoficerëve dhe dhënien e gradës, në përfundimin e kursit, e ka Komandanti i Akademisë së Nënoficerëve.

#### Neni 13

1. Titullimi oficer aktiv dhe dhënia e gradës së parë të oficerit bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

2. Gradën nëntoger e marrin studentët që mbarojnë arsimin e lartë ushtarak në akademitë ushtarake brenda ose jashtë vendit të njësuara me to dhe titullohen oficerë aktivë.

3. Të drejtën e propozimit për titullimin oficer aktiv dhe për dhënien e gradës nëntoger e ka titullari i institucionit të arsimit të lartë ushtarak.

4. Gradat ushtarake të oficerëve, nga nëntoger deri në kolonel, jepen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, sipas propozimit të komisioneve të karrierës.

5. Gradat madhore u jepen oficerëve me dekret të Presidentit të Republikës dhe me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

6. Gradat e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe, në kohë lufte, Komandantit të Forcave të Armatosura, jepen me dekret të Presidentit të Republikës dhe me propozimin e Kryeministrit.

#### Neni 14

Gradat ushtarake për oficerët rezervë jepen në bazë të vjetërsisë në shërbim dhe të funksionit organik, kur plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

#### Neni 15

1. Ushtarakut i lind e drejta për gradimin e radhës kur plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) afatin kohor të qëndrimit në një gradë, sipas nenit 10 të këtij ligji;
- b) arsimimin dhe kualifikimin e nevojshëm në shkollë e kurse, ushtarake e civile;
- c) rezultatet e vlerësimeve vjetore të punës.

2. Ushtarakët, për marrjen e çdo grade më të lartë se ajo që kanë, kanë të drejtë të shqyrtohen e të vlerësohen nga komisionet e gradave e të karrierës për çdo gradë, si më poshtë:

- a) nënoficerët vetëm 1 herë;
- b) oficerët me gradën toger deri në kolonel (kapiten i rangut I) 2 herë;
- c) oficerët me gradën gjeneral brigade e lart vetëm 1 herë.

3. Gradimi, sipas këtij ligji, do të bëhet në përputhje me nevojat organike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, brenda muajit janar të çdo viti, i paraqet Ministrit të Mbrojtjes nevojat organike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për vitin në vazhdim.

#### Neni 16

Ushtarakët e forcave tokësore, për të fituar gradën e radhës, duhet të plotësojnë kriteret e arsimimit dhe të kualifikimit si më poshtë:

1. Oficerët:

a) togeri, për të fituar gradën e kapitenit, të ketë kryer kursin e komandantit të kompanisë, kursin e oficerit të shtabit të batalionit në Akademinë e Forcave Tokësore ose kurse të njësuara me to jashtë vendit;

b) kapiteni, për të fituar gradën e majorit, të ketë kryer kursin themelor të oficerit të shtabit në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse të njësuara me të në akademitë ushtarake jashtë vendit;

c) majori, për të fituar gradën e nënkolonelit, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm ose kursin e funksioneve në shtab në Akademinë e Mbrojtjes apo kurse të njësuara me to në akademitë ushtarake jashtë vendit;

ç) nënkoloneli, për të fituar gradën e kolonelit, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse të njësuara me të në akademitë ushtarake jashtë vendit;

d) koloneli, për të fituar gradën gjeneral brigade, përveç kursit të Shtabit të Përgjithshëm të ketë kryer kursin e lartë në Kolegjin e Mbrojtjes ose një kurs jashtë shtetit të barazvlefshëm me të, të ketë shërbyer në shërbimin aktiv jo më pak se 24 vjet dhe të ketë mbajtur gradën kolonel jo më pak se 4 vjet;

dh) gradimi në gjeneral major/gjeneral lejtant bëhet në bazë të aftësive profesionale, të vlerësuara nga Komisioni i Veçantë i Karrierës.

## 2. Nënoficerët:

a) nëntetari, për të fituar gradën tetar, duhet të ketë kryer kursin e përgatitjes së përgjithshme për nivelin e komandantit të skuadrës në Akademinë e Nënoficerëve;

b) tetari, për të fituar gradën rreshter, duhet të ketë kryer kursin e përgatitjes së përgjithshme për nivelin e nënoficerit të togës në Akademinë e Nënoficerëve;

c) rreshteri, për të fituar gradën kapter, duhet të ketë kryer kursin e nënoficerit të shtabit të batalionit për sektorin ku do të shërbejë në shtab;

ç) kapteri, për të fituar gradën kryekapter, duhet të ketë kryer kursin e nënoficerit të shtabit të brigadës në Akademinë e Nënoficerëve për sektorin ku do të shërbejë.

## 3. Ushtarët:

a) rekruti, për të fituar gradën rekrut I, duhet të ketë kryer periudhën e plotë të përgatitjes së përgjithshme (përshtatje me jetën ushtarake) dhe atë individuale;

b) rekrut I, për të fituar gradën rekrut II, duhet të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit në togë;

c) rekruti, për të fituar gradën ushtar profesionist I, duhet të ketë kryer stërvitjen bazë;

ç) ushtari profesionist I, për të fituar gradën ushtar profesionist II, duhet të ketë kryer kursin e specialitetit.

Kurset e kryera jashtë vendit njësohen me ato të kryera brenda vendit me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

## Neni 17

Ushtarakët e forcave ajrore, për të fituar gradën e radhës, duhet të plotësojnë kriteret e arsimimit dhe të kualifikimit si më poshtë:

### 1. Oficerët:

a) togeri, për të fituar gradën e kapitenit, të ketë kryer kursin fillestar në Akademinë e Forcave Ajrore ose kursin e komandantit të kompanisë në Akademinë e Forcave Tokësore, kursin e oficerit të shtabit të batalionit ose kurse të tjera jashtë vendit të njësuara me to;

b) kapiteni, për të fituar gradën e majorit, të ketë kryer kursin themelor të oficerit të shtabit në Akademinë e Mbrojtjes, ndërsa pilotët të kenë fituar edhe klasin III për fluturim;

c) majori, për të fituar gradën e nënkolonelit, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm ose kursin e funksioneve në shtab në Akademinë e Mbrojtjes, ndërsa pilotët të kenë fituar klasin II për fluturim dhe personeli inxhiniero-teknik të ketë kryer kursin e lartë profesional, sipas specialiteteve në Akademinë e Forcave Ajrore;

ç) nënkoloneli, për të fituar gradën e kolonelit, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse të njësuara me të në akademitë ushtarake jashtë vendit;

d) koloneli, për të fituar gradën gjeneral brigade, përveç kursit të Shtabit të Përgjithshëm, të ketë kryer kursin e lartë në Kolegjin e Mbrojtjes ose një kurs jashtë shtetit të barazvlefshëm me të, të ketë shërbyer në shërbimin aktiv jo më pak se 24 vjet dhe të ketë mbajtur gradën kolonel jo më pak se 4 vjet;

dh) gradimi në gjeneral major/gjeneral lejtant bëhet në bazë të aftësive profesionale, të vlerësuara nga Komisioni i Veçantë i Karrierës.

2. Nënoficerët:

a) nëntetari dhe tetari i Forcave Ajrore e fitojnë gradën njëlloj si nënoficerët e forcave tokësore;

b) rreshteri dhe kapteri, përveç kriterëve si kapterët e forcave tokësore, të kenë fituar titullin “specialist i klasit II” në specialitetin përkatës;

c) për të fituar gradën kryekapter, përveç kriterëve të mësipërme, të ketë fituar titullin “specialist i klasit I” në specialitetin përkatës.

3. Ushtarët:

a) rekruti, për të fituar gradën rekrut I, duhet të ketë kryer periudhën e plotë të përgatitjes së përgjithshme (përshtatjen me jetën ushtarake) dhe atë individuale;

b) rekruti I, për të fituar gradën rekrut II, duhet të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit në togë;

c) rekruti, për të fituar gradën ushtar profesionist I, duhet të ketë kryer stërvitjen bazë;

ç) ushtari profesionist I, për të fituar gradën ushtar profesionist II, duhet të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit në nënrepart (kompani, bateri).

Kurset e kryera jashtë vendit njësohen me ato të kryera brenda vendit me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

## Neni 18

Ushtarakët e forcave detare, për të fituar gradën e radhës, duhet të plotësojnë kriteret e arsimimit dhe të kualifikimit si më poshtë:

1. Oficerët:

a) nënlejtanti, për të fituar gradën lejtant, të ketë kryer kursin e kualifikimit për zëvendëskomandant anijeje në Akademinë Detare, si dhe të ketë dhënë provimet për vetëdrejtim, sipas funksionit organik;

b) lejtanti, për të fituar gradën kapiten lejtant, të ketë kryer kursin e kualifikimit për zëvendëskomandant anijeje, si dhe të ketë dhënë provimet për vetëdrejtim, sipas funksionit organik (vetëdrejtimi i anijes);

c) kapiten lejtanti, për të fituar gradën kapiten i rangut III, të ketë kryer kursin themelor të oficerit të shtabit në Akademinë e Mbrojtjes ose kursin e kualifikimit për oficer shtabi distrikti detar e komandant flotiljeje në Akademinë e Detarisë, si dhe të ketë dhënë provimet për vetëdrejtim, sipas funksionit organik;

ç) kapiteni i rangut III, për të fituar gradën kapiten i rangut II, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm ose kursin e funksioneve në shtab në Akademinë e Mbrojtjes, si dhe të ketë dhënë provimet për vetëdrejtim, sipas funksionit organik;

d) kapiteni i rangut II, për të fituar gradën kapiten i rangut I, të ketë kryer kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes ose kurse të njësuara me të në akademitë ushtarake jashtë vendit;

dh) kapiteni i rangut I, për të fituar gradën kundëradmiral, përveç kursit të Shtabit të Përgjithshëm, të ketë kryer kursin e lartë në Kolegjin e Mbrojtjes ose një kurs jashtë shtetit të barazvlefshëm me të, të ketë shërbyer në shërbimin aktiv jo më pak se 24 vjet dhe të ketë mbajtur gradën kapiten i rangut I jo më pak se 4 vjet;

e) gradimi në nënadmira/admiral bëhet në bazë të aftësive profesionale, të vlerësuara nga Komisioni i Veçantë i Karrierës.

2. Nënoficerët:

a) nëntetarët dhe tetarët e fitojnë gradën njëlloj si nënoficerët e forcave tokësore;

b) tetari, për të fituar gradën rreshter, duhet të ketë kryer kursin fillestar të kualifikimit të nënoficerëve pranë Akademisë së Detarisë;

c) rreshteri, për të fituar gradën kapter, duhet të ketë kryer kursin e avancuar të kualifikimit të nënoficerëve në Akademinë e Detarisë;

ç) kapteri, për të fituar gradën kryekapter, përveç kurseve të mësipërme, të ketë kryer kurs të veçantë kualifikimi në specialitetin përkatës në Akademinë e Detarisë.

3. Ushtarë/detarë:

a) rekruti, për të fituar gradën detar I, duhet të ketë kryer periudhën e plotë të përgatitjes së përgjithshme (përshtatje me jetën ushtarake) dhe atë individuale;

b) detari I, për të fituar gradën detar II, duhet të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit në togë;

c) rekruti, për të fituar gradën detar profesionist I, duhet të ketë kryer stërvitjen bazë;

ç) detari profesionist I, për të fituar gradën detar profesionist II, duhet të ketë kryer periudhën e plotë të kompaktësimit në nënrepart (kompani, bateri).

Kurset e kryera jashtë vendit njësohen me ato të kryera brenda vendit me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 19

1. Oficeri dhe nënoficeri, që kryejnë detyra në specialitete në Forcat e Armatosura si mjek, jurist, inxhinier, ekonomist dhe funksione të ngjashme të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, gradën deri në major, rreshter (kapiten i rangut III) e fitojnë sipas vjetërsisë në shërbimin ushtarak dhe jo sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 16, 17 dhe 18 të këtij ligji.

2. Për të fituar grada të tjera të larta, duhet të kryejnë kurse kualifikimi, sipas funksioneve organike, në akademitë ushtarake brenda ose jashtë vendit, sipas profesionit dhe llojit të forcës ku shërben, ndërsa për të fituar grada madhore, të kenë kryer Akademinë e Mbrojtjes ose akademi ushtarake jashtë vendit të njësuara me të.

3. Kur oficerët e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni kërkojnë të përparojnë në gradë e karrierë, sipas përcaktimeve të paragrafit të dytë të këtij neni, organet kompetente janë të detyruara t'u ofrojnë kurset e nevojshme të arsimimit dhe kualifikimit.

#### Neni 20

Gradimi i parakohshëm i ushtarakëve për gradën e radhës mund të bëhet vetëm një herë gjatë karrierës ushtarake, jo më parë se një vit nga plotësimi i afatit kohor të qëndrimit në një gradë.

#### Neni 21

1. Autoritete përgjegjëse për vlerësimin e përparimit të oficerëve në gradë dhe karrierë, si dhe për kualifikimin brenda dhe jashtë vendit janë komisionet e karrierës.

2. Komisionet e karrierës janë:

a) Komisioni i Veçantë i Karrierës në Ministrinë e Mbrojtjes, i cili vlerëson oficerët me gradë madhore;

b) Komisioni i Lartë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i cili vlerëson oficerët me gradë nga kapiten (kapiten lejtant) deri te kolonel (kapiten i rangut I) dhe kapterët për gradën e kryekapterit;

c) Komisioni i Zakonshëm në Komandat e Forcave, Komandën e Stërvitjes dhe të Doktrinës, Komandën e Mbështetjes Logjistike dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për repartet e varësisë së drejtëpërdrejtë, i cili vlerëson oficerët me gradë nëntoger, toger (nënlejtant, lejtant) dhe nënoficerët nga nëntetar deri në rreshter.

3. Komisionet e karrierës në Ministrinë e Mbrojtjes, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në Komandat e Forcave, Komandën e Stërvitjes dhe Doktrinës, Komandën e Mbështetjes Logjistike dhe në njësitë autonome të Shtabit të Përgjithshëm krijohen nga Ministri i Mbrojtjes, me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

4. Përbërja e komisioneve të karrierës është si më poshtë:

a) Komisioni i Veçantë i Karrierës përbëhet nga:

- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm kryetar,
- një gjeneral majoranëtar,
- tre gjeneralë brigade të specialiteteve të ndryshmeanëtarë.

Komisioni i Veçantë i Karrierës mblidhet me kërkesë të Ministrit të Mbrojtjes për të vlerësuar dhe rekomanduar gradimin e oficerëve në grada madhore;

b) Komisioni i Lartë i Karrierës përbëhet nga:

- një gjeneral major, në raste të veçanta, gjeneral brigade kryetar,
- tre gjeneralë brigade të specialiteteve të ndryshmeanëtarë,
- tre kolonelë (kapiten i rangut I) të specialiteteve të ndryshme anëtarë.

Komisioni i Lartë i Karrierës mblidhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes për të vlerësuar dhe propozuar për gradim ushtarakët nga kapiten deri te kolonel dhe kapterët, të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Komisioni i Lartë i Karrierës mblidhet sipas afateve të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes;

c) Komisioni i Zakonshëm i Karrierës përbëhet nga:

- një gjeneral brigade kryetar,
- gjashtë kolonelë (kapiten i rangut I) të specialiteteve të ndryshme anëtarë;

Komisioni i Zakonshëm i Karrierës mblidhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes për të vlerësuar dhe propozuar për gradim nëntogerët, togerët dhe nënoficerët e karrierës, të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Komisioni i Zakonshëm i Karrierës mblidhet sipas afateve të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes.

5. Funksionimi, detyrat dhe të drejtat e komisioneve të karrierës përcaktohen me rregullore të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes.

Nuk bëjnë pjesë në komisionet e karrierës:

- Ministri dhe Zëvendësministri i Mbrojtjes;
- Sekretari i Përgjithshëm;
- Shefi i Kabinetit apo Këshilltari Ushtarak i Ministrit të Mbrojtjes;
- Këshilltari Ushtarak i Presidentit të Republikës;
- Këshilltari Ushtarak i Kryeministrit;
- Oficerët e shërbimeve informative.

6. Kurset dhe kualifikimet e kryera në akademitë dhe kolegjet e huaja jashtë vendit njësohen me ato të kryera brenda vendit, sipas ligjeve në fuqi për barazvlerësimin e diplomave.

7. Komisionet e gradave të karrierës i përfundojnë procedurat e punës së tyre brenda muajit qershor të çdo viti.

## Neni 22

1. Njësimi i gradave me funksionet e larta në hierarkinë e komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FASH) është:

- a) Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FASH - Gjeneral Lejtant
- b) Zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm të FASH - Gjeneral Major
- c) Komandant i Forcave Tokësore- Gjeneral Major
- ç) Komandant i Forcave Ajrore- Gjeneral Major
- d) Komandant i Forcave Detare- Nënadmiral
- dh) Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes - Gjeneral Brigade
- e) Komandant i Komandës së Mbështetjes Logjistike - Gjeneral Brigade
- ë) Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm - Gjeneral Brigade
- f) Komandant i Brigadës së Reagimit të Shpejtë - Gjeneral Brigade
- g) përfaqësues ushtarak në NATO - Gjeneral Brigade

2. Statusi i gjeneralëve, pas daljes së tyre në rezervë/lirim, rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Njësimi i gradave me funksionet e tjera, që nuk përfshihen në paragrafin e parë të këtij neni, në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit dhe të drejtimit të Forcave të Armatosura, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.

#### Neni 23

1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve ligjore të punës për periudhën sa zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në mbarim të kësaj periudhe, ushtaraku rimerr funksionin e tij, me përjashtim të rastit kur dënohet me heqje lirie.

2. Ushtaraku pezullohet:

a) kur ndaj tij fillon ndjekja penale dhe vendoset masa e sigurisë arrest me burg, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata;

b) për periudha studimi, më shumë se 6 muaj, të ndërmarra me nismën e vetë ushtarakut, por në lidhje me profesionin që ai ushtron.

3. Gjatë periudhës së pezullimit ushtaraku nuk paguhet. Në rastin e parashikuar në pikën 2 shkronja "a" të këtij neni, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë deklarohet i pafajshëm, ushtarakut i jepet paga bazë e funksionit të tij, që nga çasti i pezullimit.

4. Periudha e kohës së pezullimit nga detyra njihet si vjetërsi grade dhe shërbimi në Forcat e Armatosura, kur pezullimi ndodh për rastin e parashikuar në pikën 2 shkronja "a" të këtij neni dhe çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë deklarohet i pafajshëm; ndërsa për rastin e parashikuar në pikën 2 shkronja "b", periudha e pezullimit njihet vetëm për efekt të vjetërsisë së gradës.

5. Pezullimi i oficerit nga detyra bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa i nënoficerit dhe ushtarit me pagesë me urdhër të komandantit të forcës.

#### Neni 24

1. Ushtaraku del në rezervë kur:

a) nuk përparon në gradë;

b) bëhen ndryshime strukturore ose shkurtime në numrin e personelit të Forcave të Armatosura dhe sistemimi në një detyrë tjetër është i pamundur;

c) ka plotësuar afatin e kontratës;

ç) paraqet kërkesën e tij dhe miratohet nga organi përgjegjës.

2. Oficerët dalin në rezervë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

3. Nënoficerët dhe ushtarët me pagesë dalin në rezervë me urdhër të komandantit të forcës.

4. Oficeri, nënoficeri dhe ushtari profesionist/me pagesë për të dalë në rezervë paraqesin kërkesë, e cila shqyrtohet nga organi përgjegjës. Në rast se organi përgjegjës nuk kthen përgjigje brenda 3 muajve, kërkesa quhet e miratuar.

#### Neni 25

1. Ushtaraku del në lirim kur:

a) ka plotësuar moshën për pension pleqërie;

b) është dënuar me burgim me vendim gjykate të formës së prerë;

c) bëhet i paafte nga ana shëndetësore për shërbim ushtarak, deklaruar me vendim të Komisionit të Spitalit Qendror Ushtarak;

ç) paraqet kërkesën e tij dhe miratohet nga organi përgjegjës;

d) konstatohet papërshtatshmëria me vendin e punës, sipas ligjit "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura".

2. Oficerët dalin në lirim me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.
3. Nënoficerët dhe ushtarët profesionistë/me pagesë paraqesin kërkesë me shkrim për të dalë në lirim për t'u miratuar nga organi përgjegjës. Në rast se organi përgjegjës nuk kthen përgjigje brenda 3 muajve, kërkesa quhet e miratuar.

#### Neni 26

Kur ushtaraku lirohet nga detyra, deri në çastin e emërimit të tij në një detyrë tjetër apo të nxjerrjes në rezervë/lirim, paguhet me pagën mujore të gradës që mban, por jo më tepër se 2 muaj.

#### Neni 27

1. Për të gjitha mosmarrëveshjet që lindin në procedurën e dhënies së gradave, uljen në gradë, nxjerrjen në rezervë/lirim nga shërbimi ushtarak në Forcat e Armatosura, ushtaraku ka të drejtë të ankohet te Ministri i Mbrojtjes brenda 30 ditëve. Për rishqyrtimin e ankesave Ministri i Mbrojtjes krijon një komision tjetër nga ai i parashikuar në nenin 22 dhe brenda 30 ditëve jepen përgjigjet përkatëse.

2. Kur mosmarrëveshja nuk zgjidhet, sipas pikës 1 të këtij neni, ushtarakut i lind e drejta të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve.

3. Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose me lirimin e ushtarakut nga Forcat e Armatosura, ai ka të drejtë të rikthehet në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të njëjtë me atë të mëparshmen.

#### Neni 28

Ushtarakët që dalin në lirim për efekt moshe, paaftësie shëndetësore, si dhe ata që dalin në rezervë gëzojnë të drejtën e mbajtjes së uniformës ushtarake dhe të gradës që kishin në çastin e daljes në rezervë/lirim, si dhe përdorimin e saj vetëm në rastet e festave zyrtare dhe të ceremonive të ndryshme ushtarake.

#### Neni 29

1. Ushtarakët në rezervë rikthehen në shërbimin aktiv vetëm në rastet kur:
  - a) bëhen shtesa në numrin e personelit të Forcave të Armatosura;
  - b) bëhet mobilizimi i përgjithshëm ose i pjesshëm.
2. Në këto raste ata mbajnë gradën e fundit që kishin në çastin e daljes në rezervë.

#### Neni 30

Gradimet e radhës bëhen një herë në vit në muajin shtator.

#### Neni 31

Forma dhe ndërtimi i gradave ushtarake caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 32

Në rastet e riorganizimit strukturor të Forcave të Armatosura, për mungesë funksioni organik që nuk përputhet me gradën që mban ushtaraku, me pëlqimin e ushtarakut, atij i krijohet mundësia e kryerjes së shërbimit në një funksion më të ulët duke mbajtur gradën që ka, por jo më shumë se 3 vjet.

KREU IV  
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 33

1. Oficerët që mbajnë gradën kapiten I dhe, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, plotësojnë kriteret për fitimin e një grade më të lartë, gradohen major. Të tjerët mbajnë gradën kapiten I deri në testimin e radhës.

Nënoficerët që mbajnë gradat kapter V marrin gradën nëntetar.

Nënoficerët që mbajnë gradat kapter IV dhe III marrin gradën tetar.

Nënoficerët që mbajnë gradat kapter II dhe kapter I marrin gradën rreshter.

Nënoficerët që mbajnë gradat kapter dhe kryekapter mbajnë të njëjtat grada.

2. Lejohet një mospërputhje gradë-funksion në Forcat e Armatosura deri në masën 15 % të personelit ushtarak aktiv.

3. Për ushtarakët që në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë plotësuar kohën maksimale të qëndrimit në gradë e vjetërsi si oficer, sipas shkronjës "a" të nenit 11 të këtij ligji, dalja në rezervë të përfundojë deri në fund të vitit 2006.

Koha e daljes në rezervë përcaktohet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes pas propozimit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

4. Kriteret dhe autoriteti i dhënies së gradës, përparimi në gradë dhe karrierë, për oficerët që kryejnë detyra në prokuroritë dhe gjykatat ushtarake, rregullohen me ligj të veçantë.

5. Përputhja e gradave me funksionet të përfundojë brenda vitit 2004.

Neni 34

Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Mbrojtjes të nxjerrin aktet e nevojshme në zbatim të këtij ligji brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 35

Ligji nr.8670, datë 26.10.2000 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që bie në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 36

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4148, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Alfred Moisiu**

**UDHËZIM**  
**Nr.5781, datë 23.12.2003**

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT, PEZULLIMIT DHE HEQJES SË  
LICENCEVE, LEJEVE, CERTIFIKATAVE DHE AUTORIZIMEVE PËR USHTRIMIN E  
VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, ndryshuar me ligjin nr.7723, datë 21.6.1993 “Për një shtesë në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991”, ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar me ligjin nr.9096, datë 3.7.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 6.6.2002”, të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për qeverisjen vendore”, ligjit nr.8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrative të Republikës së Shqipërisë”,

duke adoptuar normat e Bashkimit European, Konferencës Europiane të Ministrave të Transportit (ECMT/CEMT) dhe të Kombeve të Bashkuara të zbatueshme në transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave;

me qëllim rregullimin, disiplinimin dhe monitorimin e veprimtarisë së ushtruar ose që kërkohet të ushtrohet nga personat fizikë dhe juridikë në fushën e transporteve rrugore, si dhe integrimin e plotë të tyre në tregun european të transportit rrugor, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit

**UDHËZON:**

**KREU I**  
**QËLLIMI DHE PËRKUFIZIME**

**1. Qëllimi**

1.1 Ky udhëzim përcakton kriteret dhe procedurat për lëshimin, pezullimin dhe heqjen e licenceve, lejeve, certifikatave dhe autorizimeve, subjekteve fizike dhe juridike të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, si edhe lëshimin e lejeve (autorizimeve) të transportit dhe operimit në territorin shqiptar për subjektet e huaja.

1.2 Ky udhëzim zbatohet në transportin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve.

**2. Përkufizime**

Për qëllimin e këtij udhëzimi, jepen përkufizimet e termave që përdoren në transportin rrugor, të unifikuar me termat e përdorur në direktivat dhe rezolutat e ECMT/CEMT, Bashkimit European, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale në transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave.

2.1 Ministri: Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit.

2.2 Ministria: Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit.

2.3 Autoriteti kompetent: autoriteti nga i cili varen organet përkatëse të transportit dhe që është kompetent, në territorin ku kanë selinë subjektet për lëshimin e licenceve, lejeve të operimit, lejeve të transportit, certifikatave dhe autorizimeve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe në bazë të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

2.4 Organe transporti: organet dhe zyrat që merren me transportin rrugor në ministri dhe organet vartëse të saj, si dhe zyrat në qark, bashki dhe komunë.

2.5 Licencë (leje për ushtrim veprimtarie) transporti: leje, për një periudhë të caktuar kohe dhe për një numër të pakufizuar udhëtimesh, për të kryer veprimtari transporti udhëtarësh dhe veprimtari transporti mallrash për të tretë dhe me qira brenda dhe/ose jashtë vendit.

2.6 Leje transporti (autorizim, leje bilaterale transporti): leje transporti ndërkombëtar bilateral për udhëtarë ose për mallra për të kryer një ose disa udhëtime vajtje-ardhje ose për të kryer një numër të pakufizuar udhëtimesh në linjë të rregullt udhëtarësh për një periudhë të caktuar kohe, që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2.7 Leje operimi (autorizim): dhënie e së drejtës operatorëve të huaj të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve në linjë të rregullt ose vajtje-ardhje që të operojnë për një periudhë të caktuar kohe dhe për një numër të pakufizuar udhëtimesh, si dhe vetëm për një pjesë të udhëtimit të tyre, brenda territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë.

2.8 Leje (autorizim) ECMT/CEMT: leje transporti (autorizim) ndërkombëtar multilateral shumëudhëtimsh dhe për një periudhë të caktuar kohe, për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të mallrave ndërmjet dy e më shumë shteteve anëtare të Konferencës Europiane të ministrave të transportit (ECMT/CEMT).

2.9 Certifikatë: dokument që mbahet në mjet dhe që

a) provon zotërimin e licencës dhe lejes për rastet e transporteve rrugore të brendshme dhe ndërkombëtare që janë subjekte licencimi;

b) i jep një mjet rrugor me motor, të drejtën e operimit në transportet rrugore të brendshme dhe ndërkombëtare, për rastet e transporteve të mallrave për llogari të vet.

2.10 Dokument kontrolli: certifikatë, leje transporti, leje operimi, autorizim, fletë ose libër udhëtimi, policë-ngarkesë, faturë e shitjes/blerjes së mallit, lista e udhëtarëve, kontrata e udhëtimit, që mbahen në original ose në kopje të notuara në bordin e automjetit gjatë gjithë udhëtimit dhe që shërbejnë për kontrollin e veprimtarisë të subjektit që kryen transportin.

2.11 Autobus: automjet i destinuar për transport njerëzish me më shumë se nëntë ndenjëse, duke përfshirë dhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit.

2.12 Autoveturë: automjet i destinuar për transport njerëzish, që kanë maksimumi nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit.

2.13 Taksi: autoveturë e pajisur me licencë për transport të rastësishëm ose të prenotuar të udhëtarëve dhe që ka jo më pak se katër ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe jo më pak se katër dyer për autoveturat me më pak se nëntë ndenjëse, dhe jo më pak se tri dyer funksionale për autoveturat me nëntë ndenjëse, duke përfshirë ndenjësen e drejtuesit të mjetit.

2.14 Kamion: automjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave.

2.15 Kompleks mjete: kombinim i dy mjeteve rrugore për transport mallrash, prej të cilave njëri është me motor dhe tjetri rimorkio ose gjysmërimorkio. Për efekt të pajisjes me leje transporti bilateralë, kompleksi i automjeteve konsiderohet një i vetëm.

2.16 Automjet i huazuar: çdo mjet rrugor, i cili me pagesë dhe për një periudhë të caktuar kohe, mbahet nga një sipërmarrës i cili e përdor për transport udhëtarësh ose mallrash, kundrejt shpërblimit ose për llogari të vet, duke pasur një kontratë huapërdorje ose qiraje me pronarin e automjetit.

2.17 Mallra të rrezikshme: ato mallra (substancë dhe artikuj) të klasifikuar dhe të shënuar si të rrezikshme nga Marrëveshja Europiane për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR), transporti ndërkombëtar i të cilave në rrugë është i ndaluar ose i lejuar vetëm në kushtet e caktuara nga kjo Marrëveshje.

2.18 Transport i brendshëm mallrash ose udhëtarësh: transporti i mallrave ose udhëtarëve për të tretë dhe me qira ose për llogari të vet, me itinerar që shtrihet tërësisht brenda territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë.

2.19 Transport ndërkombëtar mallrash ose udhëtarësh: transporti i mallrave ose udhëtarëve për të tretë dhe me qira ose për llogari të vet, me itinerar që shtrihet pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë dhe kur ky territor shërben si origjinë dhe/ose destinacion i udhëtimit.

2.20 Transit: udhëtim përmes territorit të një shteti në të cilin nuk ngarkohen apo shkarkohen mallra ose ku nuk hipin apo zbresin udhëtarë.

2.21 Sipërmarrës (sipërmarrje) transporti rrugor: çdo person fizik, çdo person juridik, me qëllime fitimi ose jo, çdo shoqatë ose grup individësh që nuk janë person juridik, me qëllime fitime ose jo, ose çdo organizëm zyrtar, që është ose jo person juridik ose që varet tek një autoritet që është person juridik, i cili ka si objekt veprimtarinë e transportit rrugor të mallrave ose udhëtarëve.

2.22 Operator ndërkombëtar transporti: të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kryejnë transport rrugor ndërkombëtar të mallrave dhe të udhëtarëve me autobus.

2.23 Transport i rregullt udhëtarësh: shërbim në linjë të rregullt transporti me frekuencë dhe itinerare të pandryshuara, ku udhëtarët mund të merren dhe të lihen në vendqëndrime të përcaktuara më parë. Shërbimet e rregullta mund të shfrytëzohen nga të gjithë, përjashto rastet kur prenotimi është i detyruar. Ky shërbim kryhet vetëm me autobusë dhe mund të jetë qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar dhe shërbim i rregullt i specializuar:

2.23.1 Transporti qytetës: shërbimi i rregullt i transportit me autobusë, që plotëson nevojat e popullsisë së një qyteti, brenda vijave kufizuese të tij ose duke lidhur qendra të rëndësishme ekonomike dhe sociale me pjesët e tjera të qytetit.

2.23.2 Transporti rrethqytetës: shërbimi i rregullt i transportit me autobusë, i cili plotëson nevojat e popullsisë, ndërmjet

- a) bashkive brenda të njëjtit rreth;
- b) qendrës së komunës në drejtim të bashkisë të të njëjtit rreth dhe anasjelltas;
- c) qendrave të komunave të një rrethi (pa lejim kalimi në qytet);
- d) qendrave të banuara të një komune në drejtim të qendrës së komunës dhe/ose të një komune tjetër dhe anasjelltas;
- e) qendrave të banuara të një komune.

2.23.3 Transporti ndërqytetës: shërbimi i rregullt i transportit me autobusë, që plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet

- a) bashkive qendër të rretheve të ndryshme brenda një qarku;
- b) bashkive qendër të rretheve për qarqe të ndryshëm;
- c) bashkisë joqendër rrethi me qendra rrethi të qarqeve të ndryshme;
- d) bashkive qendër të rretheve me stacionet hekurudhore skajore, për vazhdimin e udhëtimit, duke ndryshuar llojin e transportit, aeroportin, portin ose bankinën liqenore.

2.23.4 Shërbimet e transportit ndërkombëtar në linjë të rregullt: shërbim në linjë të rregullt ndërkombëtare transporti në përputhje me marrëveshjet bilaterale të transportit rrugor ku Republika e Shqipërisë është palë.

2.23.5 Shërbimet e rregullta të specializuara të transportit: shërbimet e rregullta të transportit që sigurojnë shërbim për një kategori të caktuar udhëtarësh, duke përjashtuar udhëtarët e tjerë, përderisa transporte të tilla të kryhen në përputhje me kushtet e përcaktuara nga pika 2.23. Shërbimet e rregullta të specializuara përfshijnë veçanërisht,

- a) transportin shtëpi-punë të punonjësve;
- b) transportin shtëpi-institucion shkollor të nxënësve dhe studentëve;
- c) transportet qytetëse ndërkufitare, për rastet kur lejohen me marrëveshje ndërkombëtare.

Klasifikimi i këtyre shërbimeve si shërbime të rregullta nuk cenohet nga fakti që ato mund të ndryshojnë në përputhje me kërkesat e përdoruesve.

2.24 Shërbimet e transportit vajtje-ardhje (lavjerrës) të udhëtarëve.

2.24.1 Shërbime transporti vajtje-ardhje (lavjerrës) të udhëtarëve: shërbime që organizohen për të transportuar grupe udhëtarësh të formuar më parë nga e njëjta zonë nisjeje dhe me të njëjtën zonë destinacioni me udhëtime të përsëritura vajtje dhe kthim. Të tilla grupe, të përbëra nga udhëtarë që kanë kryer udhëtimin e vajtjes, rikthehen në zonën e nisjes me anën e një udhëtimi pasues.

Zonë nisje dhe destinacioni quhen vendet, së bashku me lokalitetet rrethuese, në të cilat respektivisht fillon dhe mbaron udhëtimi.

2.24.2 Në shërbimin vajtje-ardhje (lavjerrës) nuk merren ose lihen udhëtarë gjatë udhëtimit.

2.24.3 Udhëtimi i parë në kthim dhe udhëtimi i fundit në vajtje, për një seri udhëtimesh lavjerrës, duhet të kryhet me autobus bosh.

2.24.4 Në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, klasifikimi i një operacioni transporti si shërbim lavjerrës, nuk cenohet nga fakti që, me autorizim të autoritetit kompetent për territorin e shtetit ku zhvillohet transporti,

a) udhëtarët të kryejnë udhëtimin e kthimit me një grup tjetër ose me një operator tjetër transporti, pavarësisht kushtit të pikës 2.24.1;

b) udhëtarët të merren dhe të lihen gjatë udhëtimit, pavarësisht kushtit të pikës 2.24.2;

c) udhëtimi i parë në vajtje dhe udhëtimi i fundit në kthim për një seri udhëtimesh lavjerrës, të kryhet me autobusin bosh, pavarësisht kushtit të pikës 2.24.3.

#### 2.25 Shërbimet e transportit të rastit të udhëtarëve

2.25.1 Shërbime transporti të rastit: ato shërbime transporti që nuk i përgjigjen përkufizimit të shërbimeve të rregullta dhe atij të shërbimeve lavjerrës.

Në shërbimet e rastit, nuk lejohen të lihen ose të merren udhëtarë gjatë udhëtimit, me përjashtim të rasteve kur kjo autorizohet nga autoriteti kompetent për territorin ku kryhet transporti.

Këto shërbime transporti nuk e humbin karakterin e shërbimit të rastit për faktin se mund të kryhen me një frekuencë të caktuar.

##### 2.25.2 Shërbimet e rastit përfshijnë:

a) Udhëtimet “me dyer të mbyllura”, që janë shërbimet e kryera me të njëjtin automjet që transporton të njëjtin grup udhëtarësh të formuar më parë, duke i kthyer në vendin e nisjes.

b) Shërbimet që kryhen me udhëtimin e vajtjes plot dhe udhëtimin e kthimit bosh. Vendi i nisjes ndodhet në territorin ku transportuesi ka selinë.

c) Shërbimet në të cilat udhëtimi i vajtjes kryhet bosh dhe të gjithë udhëtarët merren në të njëjtin vend, duke plotësuar kushtet si vijojnë:

c.1 Udhëtarët krijojnë grupe, në territorin e një vendi tjetër nga ai ku ka selinë operatori i transportit ose në vendin ku merren, që janë formuar me një kontratë transporti të lidhur përpara arritjes në atë vend. Udhëtarët transportohen në vendin ku operatori i transportit ka selinë.

c.2 Udhëtarët janë dërguar më parë nga i njëjti operator transporti, me kushtet e shkronjës “b” më sipër, në vendin ku ata merren përsëri dhe transportohen në territorin e vendit ku operatori i transportit ka selinë.

c.3 Udhëtarët janë ftuar të shkojnë në territorin e një vendi tjetër dhe kostoja e transportit përballohet nga personi që ka dërguar ftesën. Këta udhëtarë duhet të formojnë një grup homogjen, i cili nuk është krijuar vetëm për të ndërmarrë këtë udhëtim dhe që kthehet përsëri në territorin ku operatori i transportit ka selinë.

2.25.3 Për kuptimin e pikës 2.24 dhe 2.25 me grup të formuar më parë do të quajmë një grup për të cilin një organizëm ose një person përgjegjës, në përputhje me normat e shtetit ku ka selinë, është ngarkuar të marrë masa për nënshkrimin e kontratës ose për pagesën kolektive të shërbimit ose për marrjen e të gjitha prenotimeve dhe pagesave përpara nisjes.

2.26 Transportet e udhëtarëve për llogari të vet: transportet e kryera nga një ndërmarrje ose institucion për punonjësit e vet apo nga një shoqatë, pa qëllime fitimi, për anëtarët e vet, në kuadrin e veprimtarisë së saj sociale, me kusht që

a) veprimtaria e transportit të përbëjë vetëm një veprimtari ndihmëse për shoqatën ose ndërmarrjen;

b) mjetet e përdorura të jenë pronë e ndërmarrjes, institucionit ose shoqatës ose të jenë të blera me këste nga këto të fundit, ose të jenë objekt i një kontrate qiramarrjeje me afat të gjatë dhe të drejtohen nga një punonjës ose anëtar i ndërmarrjes.

2.27 Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion ose kompleks mjeteesh për persona fizikë ose juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit ose kompleksit të mjeteve me qira me drejtues mjeti.

2.28 Transportet e mallrave për llogari të vet: kur malli i transportuar është pronë e sipërmarrësit të transportit ose është shitur, blerë, është dhënë ose marrë me qira, është prodhuar, nxjerrë, përpunuar ose riparuar nga sipërmarrësi i transportit. Qëllimi i transportit duhet të jetë mbartja e mallrave nga ose për tek sipërmarrësi i transportit ose lëvizja e tyre jashtë dhe brenda ndërmarrjes për kërkesat e tij. Automjetet e përdorura për këto transporte duhet të drejtohen nga

punonjës të sipërmarrësit të transportit dhe duhet të jenë pronë e tij ose të vëna në dispozicion të sipërmarrësit të transportit nëpërmjet një kontrate qiraje ose huapërdorjeje. Transporti duhet të jetë një veprimtari ndihmëse e sipërmarrësit të transportit.

2.29 Agjenci spedicionere: personat juridikë që organizojnë transportin dhe shpërndarjen e mallit nga nisësi deri në destinacion të pritësi i mallit. Përgjegjësia për ruajtjen e mallit nga humbja ose dëmtimi, nga momenti i marrjes në dorëzim dhe deri në momentin e dorëzimit të pritësi, është e spedicionerit.

2.30 Agjenci transporti udhëtarësh: personat fizikë ose juridikë që u shërbejnë udhëtarëve e bagazheve, në nisjen e udhëtimit me autobus dhe në kthim, me dhënie informacioni, pajisje me bileta, organizim udhëtimi dhe shërbime të tjera që lidhen me transportin, me qëllim mbërritjen e tyre të sigurt dhe në kohë në destinacionin e caktuar.

## KREU II PRANIMI NË TREG DHE KOMPETENCAT NË LICENCIM

### 3. Pranimi në treg

3.1 Janë subjekt licencimi personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën:

a) e transportit në linjë të rregullt të udhëtarëve, të brendshëm dhe ndërkombëtarë, sipas përcaktimeve të kreut I pika 2.23, duke përjashtuar transportet e rregullta të specializuara, sipas pikës 2.23.5 shkronjat “a” dhe “b”;

b) e shërbimit të transportit ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve, sipas kreut I pika 2.25;

c) e shërbimit të transportit ndërkombëtar vajtje-ardhje (lavjerrës) të udhëtarëve, sipas kreut I pika 2.24;

d) e transportit taksi të udhëtarëve, sipas kreut I pika 2.13;

e) e shërbimit agjenci transporti udhëtarësh, sipas kreut I pika 2.29;

f) e transportit të mallrave, të brendshëm dhe ndërkombëtar, për të tretë dhe me qira me drejtues mjeti, sipas kreut I pika 2.27;

g) e shërbimit agjenci spedicionere, sipas kreut I pika 2.30;

h) e shërbimit të konsulencës tekniko – ekonomike në transportin rrugor.

3.2 Nuk janë subjekt licencimi, por leje transporti, leje operimi, certifikatë, autorizimi ose kontrate:

a) Shërbimet e rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve, sipas kreut I pika 2.23.5 shkronjat “a” dhe “b”.

b) Shërbimet e brendshme të transportit të rastit të udhëtarëve, sipas kreut I pika 2.25.

c) Transportet e udhëtarëve, të brendshëm dhe ndërkombëtarë, për llogari të vet, sipas kreut I pika 2.26.

d) Transportet e mallrave, të brendshme dhe ndërkombëtare, për llogari të vet, sipas kreut I pika 2.28.

### 3.3 Transporti i liberalizuar i mallrave

Për të lehtësuar transportin ndërkombëtar ndërmjet vendeve anëtare të CEMT/ECMT (ku bën pjesë dhe Republika e Shqipërisë), janë përjashtuar nga kërkesat për leje transporti bilaterale ose multilaterale, kategoritë e mëposhtme të transportit:

a) Transporti i mallrave me mjete rrugore me motor, pesha e përgjithshme e lejueshme me ngarkesë e të cilit, duke përfshirë dhe rimorkiot, nuk i kalon 6 ton ose kur ngarkesa e dobishme e lejuar, përfshirë rimorkiot, nuk i kalon 3.5 ton. (Është e pavlefshme për Austrinë, Finlandën dhe Italinë.)

b) Transporti i rastësishëm i mallrave për dhe nga aeroporti në rastet kur shërbimet transferohen nga një lloj transporti në tjetrin.

c) Transporti i mjeteve rrugore që janë dëmtuar ose defektuar dhe lëvizja e mjetit të defektuar pas riparimit.

d) Vajtja pa ngarkesë e mjeteve të transportit të mallrave, të dërguara për të zëvendësuar një mjet të defektuar në një vend tjetër, dhe gjithashtu kthimi, pas riparimit, i mjetit të difektuar. (Është e pavlefshme për Federatën Ruse).

e) Transporti i gjësë së gjallë me mjete të konstruktura ose të konvertuara në mënyrë permanente, për transportin e gjësë së gjallë dhe të njohura si të tilla nga autoritetet kompetente të një vendi anëtar të ECMT/CEMT. (Është e pavlefshme për Austrinë, Republikën Çeke, Estoninë, Francën, Hungarinë, Poloninë, Federatën Ruse dhe Zvicrën.)

f) Transporti i pjesëve të këmbimit dhe furnizimet për anijet dhe avionët ndëroqeanikë. (Është e pavlefshme për Federatën Ruse dhe Republikën Çeke.)

g) Transporti i furnizimeve dhe aparaturave mjekësore që nevojiten për emergjencë, në veçanti për katastrofa natyrore dhe nevoja humanitare.

h) Transporti jo për qëllime tregtare i punimeve dhe objekteve të artit për ekspozita dhe panairë.

Në marrëveshjet bilaterale të transportit ndërkombëtar rrugor, ku Republika e Shqipërisë është palë, përcaktohen edhe transporte të tjera të liberalizuara mallrash, por që janë të vlefshme vetëm me shtetin që është palë në marrëveshje.

#### 4. Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës

Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës, në territorin ku ka selinë ose ushtron veprimtarinë subjekti i transportit rrugor, përcaktohet si vijon:

##### 4.1 Transporti i brendshëm i udhëtarëve

| Lloji i veprimtarisë                                         | Autoriteti që lëshon licencën  |
|--------------------------------------------------------------|--------------------------------|
| Transporti në linjë të rregullt qytetës                      | Kryetari i Bashkisë            |
| Transporti në linjë të rregullt rrethqytetës                 | Kryetari i Bashkisë/Komunës    |
| Transporti në linjë të rregullt ndërqytetës brenda qarkut    | Kryetari i Këshillit të Qarkut |
| Transporti në linjë të rregullt ndërqytetës ndërmjet qarqeve | Ministri                       |
| Transporti i udhëtarëve me taksi                             | Kryetari i Bashkisë/Komunës    |
| Agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi                      | Kryetari i Bashkisë/Komunës    |

##### 4.2 Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve

| Lloji i veprimtarisë                                  | Autoriteti që lëshon licencën |
|-------------------------------------------------------|-------------------------------|
| Shërbimet e transportit në linjë të rregullt          | Ministri                      |
| Shërbimet e rregullta të specializuara të transportit | Ministri                      |
| Shërbimet e transportit lavjerrës                     | Ministri                      |
| Shërbimet e transportit të rastit                     | Ministri                      |
| Agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh            | Ministri                      |

##### 4.3 Transporti i mallrave brenda vendit

| Lloji i veprimtarisë                           | Autoriteti që lëshon licencën                                   |
|------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|
| Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira | Kryetari i Bashkisë/Kryetari i Këshillit të Qarkut për komunat. |

##### 4.4 Transporti ndërkombëtar i mallrave

| Lloji i veprimtarisë                           | Autoriteti që lëshon licencën |
|------------------------------------------------|-------------------------------|
| Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira | Ministri                      |

|                                                                       |                               |
|-----------------------------------------------------------------------|-------------------------------|
| Lloji i veprimtarisë                                                  | Autoriteti që lëshon licencën |
| 4.5 Agjenci spedicionere                                              | Ministri                      |
| 4.6 Konsulencë tekniko-ekonomiko në veprimtarinë e transportit rrugor | Ministri                      |

Licencat për transport udhëtarësh dhe mallrash brenda dhe jashtë vendit lëshohen të shoqëruara me certifikatën e automjetit me të cilin kryhet transporti. Certifikata e automjetit, në origjinal, mbahet në bordin e tij dhe shërben si dokument kontrolli. Mbajtësi i saj është i detyruar t’ua paraqesë atë organeve të kontrollit, me kërkesë të tyre.

5. Dokumentacioni prioritar, i nevojshëm për ushtrim veprimtarie transporti rrugor dhe autoriteti kompetent që e lëshon.

5.1 Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve dhe mallrave me një shtet me të cilin Republika e Shqipërisë është palë në një marrëveshje bilaterale transporti rrugor, shoqërohet me lejen e transportit (autorizim) të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit/shteteve, në territorin e të cilit/cilëve transiton ose realizohet pjesërisht transporti. Lejet e transportit (autorizimet) shpërndahen nga ministria ose organet e deleguara prej saj, në bazë të marrëveshjeve bilaterale që ajo ka nënshkruar.

5.2 Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve në linjë të rregullt, që është subjekt licencimi nga ministri, kryhet në bazë të lejes së transportit (autorizimit) që lëshohet për linjën ose transportin e rregullt të specializuar, ku përshkruhet itinerari, vendqëndrimet, frekuenca javore dhe kërkesa të tjera të shërbimit në linjë.

5.3 Shërbimi i transportit ndërkombëtar lavjerrës të udhëtarëve, që është subjekt licencimi nga ministri, kryhet në bazë të autorizimit që lëshohet nga ministria për një periudhë të caktuar kohe, ku përshkruhet itinerari, vendqëndrimet, frekuenca dhe kërkesa të tjera të shërbimit lavjerrës.

5.4 Transportet e udhëtarëve që nuk janë subjekt licencimi, sipas kreut II pika 3.2, me përjashtim të shkronjës “c”, janë subjekt kontrolli të kontratës të lidhur me grupin e udhëtarëve dhe të listës së udhëtarëve.

5.5 Transporti ndërkombëtar i rastit, i udhëtarëve realizohet kundrejt lejes së transportit (autorizimit) të lëshuar nga ministria ose organet e deleguara prej saj (ANALTIR).

5.6 Transporti i mallrave të rrezikshme, i brendshëm dhe ndërkombëtar, shoqërohet me certifikatën e mallrave të rrezikshme me të cilën pajiset çdo automjet që transporton këto lloj mallrash. Kjo certifikatë lëshohet nga ministria.

5.7 Transporti ndërkombëtar i mallrave ndërmjet dy ose më shumë shteteve anëtare të ECMT/CEMT (Konferenca Europiane e Ministrave të Transportit) realizohet me anë të lejes multilaterale ECMT/CEMT, e cila lëshohet nga ministria.

5.8 Transporti i brendshëm dhe ndërkombëtar i mallrave që nuk janë subjekt licencimi, sipas kreut II pika 3.2 shkronja “d”, janë subjekt kontrolli të përkatësisë së mallit që transportohet.

5.9 Në tabelën në vijim jepet autoriteti kompetent për territorin, që lëshon lejen e transportit, autorizimin, lejen e operimit, certifikatën, sipas llojit të veprimtarisë që ushtrohet.

| Lloji i veprimtarisë                                             | Dokumenti që lëshohet                 | Autoriteti kompetent |
|------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|----------------------|
| <b>5.9.1 Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve</b>                |                                       |                      |
| - Shërbimet e transportit në linjë të rregullt                   | Leje transporti, autorizim            | Ministria            |
| - Shërbimet e rregullta të specializuara të transportit          | Leje transporti, autorizim            | Ministria            |
| - Shërbimet e transportit lavjerrës                              | Leje transporti, autorizim            | Ministria            |
| - Shërbimet e transportit të rastit                              | Leje transporti, autorizim/bilaterale | Ministria/ANAL TIR   |
| <b>5.9.2 Transporti i mallrave brenda vendit</b>                 |                                       |                      |
| - Transporti i mallrave për llogari të vet                       | certifikatë                           | Bashkia/Komuna       |
| -Transporti i mallrave të rrezikshme                             | certifikatë                           | Ministria            |
| <b>5.9.3 Transporti ndërkombëtar i mallrave</b>                  |                                       |                      |
| - Transporti i mallrave për llogari të vet                       | certifikatë/leje bilaterale           | Ministria/ANAL TIR   |
| -Transporti i mallrave të rrezikshme                             | certifikatë/leje bilaterale           | Ministria/ANAL TIR   |
| -Transporti ndërmjet dy a më shumë shteteve anëtare të ECMT/CEMT | Leje multilaterale ECMT/CEMT          | Ministria            |

### KREU III KRITERET BAZË TË LICENCIMIT

#### 6. Kriteret e licencimit

6.1 Për të ushtruar veprimtarinë e transportit të udhëtarëve dhe mallrave, e cila është subjekt licencimi, sipas kreut II pika 3.1, sipërmarrjet e transportit rrugor paraqesin kërkesë për licencim pranë autoritetit kompetent për territorin ku ato kanë selinë, sipas kreut II pika 4.

Personi fizik ose juridik, që kërkon të licencohet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve e mallrave, duhet të provojë se plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) ka reputacion të mirë,
- b) ka gjendje të përshtatshme financiare,
- c) përmbush kërkesat për kompetencë profesionale,
- d) zotëron mjete transporti rrugor me motor, në numrin dhe gjendjen teknike të kërkuar.

Kur kërkuesi i licencës (aplikanti) është një person fizik që nuk i përmbush kërkesat e shkronjës “c”, autoriteti kompetent mund ta licencojë atë me kushtin që ai të emërojë një person tjetër që plotëson kërkesat e shkronjave “a” dhe “c” më sipër, i cili do të menaxhojë efektivisht dhe në mënyrë të vazhdueshme operacionet e transportit të sipërmarrjes.

Kur aplikanti nuk është një person fizik, kërkesat e shkronjës “a” dhe “c” duhet të përmbushen nga personi ose personat që do të menaxhojnë efektivisht dhe në mënyrë të vazhdueshme operacionet e transportit të sipërmarrjes.

6.2 Kërkesa për reputacion të mirë plotësohet në rast se personi fizik ose personat që do të menaxhojnë efektivisht dhe në mënyrë të vazhdueshme operacionet e transportit të sipërmarrjes, sipas pikës 6.1:

- nuk janë shpallur fajtorë për krime ose shkelje serioze ligjore, përfshirë edhe krime ose shkelje të natyrës tregtare;
- nuk janë deklaruar të papërshtatshëm për të ushtruar veprimtarinë e operatorit të transportit;
- nuk janë shpallur fajtorë për shkelje serioze të ligjit të punës, legjislacionit të transportit dhe në veçanti për shkelje të rregullave, lidhur me kohën e drejtimit dhe pushimit për drejtuesin e mjetit, ose për legjislacionin lidhur me trafikun rrugor, sigurinë e mjetit dhe në mbrojtjen e mjedisit.

Kërkesa për reputacion të mirë do të quhet e plotësuar edhe për personin ose personat që janë deklaruar të rehabilituar.

6.3 Kërkesa për gjendje të përshtatshme financiare plotësohet kur disponohen burime të mjaftueshme financiare të cilat garantojnë që sipërmarrja e transportit të organizohet dhe menaxhohet siç duhet.

Për vlerësimin e gjendjes financiare, autoriteti kompetent merr në konsideratë:

- a) një llogari vjetore të sipërmarrjes së transportit, kur sipërmarrja ka një veprimtari vjetore dhe kur kjo llogari aplikohet për atë sipërmarrje;
- b) fondet që ajo disponon, duke përfshirë depozitat bankare dhe kapacitetin huamarrës;
- c) asetet (aktivin tregtar), përfshirë pronat të cilat sipërmarrja mund t'i lërë peng si garanci;
- d) shpenzimet, duke përfshirë çmimin e blerjes ose pagesën e kështit të parë për blerjen e mjeteve;
- e) ndërtesat dhe truallin;
- f) impiantet dhe shërbimet;
- g) makineri-pajisjet dhe kapitalin punues.

Autoriteti kompetent mund të pranojë ose të kërkojë, si provë, konfirmimin ose garancinë e lëshuar nga një bankë ose institucion sigurimi. Ky konfirmim ose garanci mund të bëhet në formën e një sigurimi bankar ose garancie ekuivalente nga një shoqëri sigurimi.

Subjekti i transportit duhet të paraqesë sigurinë bankare ose garancinë e sigurimit për vlerën:

- a) 4000 euro për mjetin e parë dhe 2000 euro për çdo mjet shtesë, kur kryen transport ndërkombëtar mallrash me leje multilaterale ECMT/CEMT;
- b) 2000 euro për mjetin e parë dhe 1000 euro për çdo mjet shtesë, kur kryen transport ndërkombëtar mallrash, vetëm me leje bilaterale ose transport ndërkombëtar të udhëtarëve;
- c) 30 000 lekë, për mjetin e parë dhe 15 000 lekë për çdo mjet, kur kryen transport të mallrave dhe të udhëtarëve brenda vendit;
- d) 10 000 euro, kur aplikon për agjenci spedicionere;
- e) 700 000 lekë, kur aplikon për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh.

6.4 Kërkesa për kompetencë profesionale plotësohet kur provohet zotërimi i njohurive të mjaftueshme juridike, tregtare, financiare dhe teknike për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor.

6.4.1 Në transportin e brendshëm rrugor të rregullt të udhëtarëve kërkesa për kompetencë profesionale plotësohet me zotërimin e diplomës në inxhinieri mekanike, ekonomi ose juridik, ose nga një eksperiencë e suksesshme të paktën trevjeçare në ushtrimin e kësaj veprimtarie.

a) Për veprimtarinë e shërbimit taksi kërkohet zotërimi i dëshmisë së aftësisë profesionale të taksistit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

b) Për veprimtarinë e Agjencisë së transportit të brendshëm të udhëtarëve është i mjaftueshëm zotërimi i diplomës së shkollës së mesme.

6.4.2 Për transportin e brendshëm rrugor të mallrave kërkesa për kompetencë profesionale plotësohet me zotërimin e kategorisë përkatëse të lejedrejtimit dhe (kur parashikohet nga Kodi Rrugor) certifikatës ose dëshmisë së aftësisë, që nevojitet për drejtimin e mjetit rrugor me motor.

6.4.3 Në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave kjo kërkesë plotësohet, përveç zotërimit të diplomës në inxhinieri mekanike, ekonomi ose juridik, edhe me zotërimin e licencës për konsulencë tekniko-ekonomike në transport rrugor, zotërimin e një dëshmie apo certifikate të lëshuar për veprimtarinë përkatëse nga DPSHTRR, Shoqata e transportuesve rrugorë shqiptarë ANALTIR ose nga një eksperiencë e suksesshme të paktën trevjeçare në ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Jepet një afat njëvjeçar për pajisjen me dëshminë ose certifikatën e nevojshme të kompetencës profesionale sipas pikës 6.4.3 më sipër. Pas këtij afati refuzohet lëshimi ose rinovimi i licencës kur nuk plotësohet kjo kërkesë.

Plotësimi i kërkesave të kompetencës profesionale në transportin ndërkombëtar të mallrave ose udhëtarëve, plotëson automatikisht edhe kërkesat e kompetencës profesionale në transportin e brendshëm përkatës.

6.5 Kërkesa për numrin dhe gjendjen teknike të mjeteve rrugore plotësohet, duke siguruar numrin e nevojshëm të automjeteve në gjendje të mirë teknike për garantimin e zhvillimit normal të veprimtarisë në përputhje me kërkesën për transport.

Gjendja e mirë teknike e mjeteve rrugore provohet me anë të certifikatave të lëshuara dhe/ose miratuara nga ministria, për plotësim të standardeve minimale teknike të nxjerrjes së gazrave dhe sigurisë rrugore. Standardet teknike për automjetet që kryejnë transportin ndërkombëtar të udhëtarëve e mallrave, duhet të jenë në përputhje me marrëveshjet bilaterale dhe rezolutat ndërkombëtare (ECMTCEMT) që rregullojnë veprimtarinë përkatëse.

6.5.1 Viti i prodhimit të autobusit që përdoret në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, duhet të jetë maksimumi 12 vjet nga viti i certifikimit të fundit të mjetit.

6.5.2 Viti i prodhimit të autobusit që përdoret në transportin e brendshëm në linjë të rregullt të udhëtarëve, duhet të jetë maksimumi 20 vjet nga viti i certifikimit të fundit të mjetit.

6.5.3 Viti i prodhimit të autoveturës që përdoret në shërbimin taksi të udhëtarëve, duhet të jetë maksimumi 15 vjet nga viti i certifikimit të fundit të mjetit.

6.5.4 Viti i prodhimit të kamionit që përdoret në transportin ndërkombëtar të mallrave, duhet të jetë maksimumi 17 vjet nga viti i certifikimit të fundit të mjetit.

6.5.5 Për subjektet fizike ose juridike që aplikojnë për herë të parë për licencim dhe/ose certifikim, kushtet e mësipërme të moshës së mjetit janë të detyrueshme.

6.5.6 Për subjektet transportuese që aplikojnë për rinovim licence dhe/ose certifikate dhe që nuk plotësojnë kushtin e mësipërm të moshës së automjetit, jepet një afat njëvjeçar për rifreskimin e inventarit të mjeteve.

6.5.7 Mjetet rrugore me motor që do të përdoren për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor, mund të jenë pronë ose të huazuara nga aplikanti me një kontratë qiraje ose huapërdorje ose blerje me këste, me kohëzgjatje të paktën njëvjeçare.

7. Lëshimi, refuzimi, pezullimi dhe heqja e licencës, lejes së transportit (autorizimit), certifikatës.

7.1 Lëshimi i licencës, autorizimit, certifikatës

7.1.1 Licenca lëshohet kur aplikanti plotëson kushtet e kreu III pika 6.1 shkronjat a, b, c, d (reputacioni i mirë, kompetenca profesionale, gjendje e përshtatshme financiare dhe zotërimi i mjeteve të transportit rrugor me motor, në numrin dhe gjendjen teknike të kërkuar).

7.1.2 Licenca, leja e transportit (autorizimi) dhe certifikata nuk mund të transferohen nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.

7.1.3 Titullari i licencës për kryerjen e veprimtarisë për të cilën është licencuar ose autorizuar, mund të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me një subjekt të tretë, por jo për më shumë se 35 % të veprimtarisë. Titullari i licencës ose i autorizimit është përgjegjes për plotësimin e kushteve të licencimit/autorizimit edhe për pjesën e veprimtarisë që kryhet nga nënkontraktori.

7.1.4 Në rast se personi fizik ose juridik ndryshon emrin, e vërtetuar kjo me vendim gjykatë ose certifikatë tatimore, me kërkesë të tij kryhet zëvendësimi përkatës i licencës, autorizimit, certifikatës me të njëjtin afat vlefshmërie dhe me një numër tjetër identifikimi, duke arkivuar përkatësisht licencën, autorizimin, certifikatën e vjetër.

7.1.5 Në rast se subjekti i transportit, brenda 60 ditëve nga dita e lëshimit, nuk tërheq licencën, autorizimin ose certifikatën, atëherë këtij i anulohet licenca, autorizimi ose certifikata. Në rastin e linjave ndërqytetëse të transportit të udhëtarëve, autoriteti kompetent në ministri ose në këshillin e qarkut njofton edhe bashkinë që ka lëshuar autorizimin për subjektin.

7.1.6 Licenca, autorizimi ose certifikata anulohet edhe me kërkesë të subjektit transportues. Në transportin e udhëtarëve në shërbimet e rregullta, autoriteti kompetent që ka lëshuar licencën, autorizimin ose certifikatën njoftohet të paktën 2 muaj përpara. Në kërkesën për anulim licencë/autorizimi/certifikatë duhet të përcaktohen data e ndërprerjes së shërbimit dhe arsyet e kësaj ndërprerjeje.

7.2 Refuzimi i kërkesës për licencim dhe leje transporti (autorizim). Kërkesa për licencim/autorizim refuzohet kur:

7.2.1 Subjekti që kërkon të licencohet nuk plotëson kushtet e kreu III pika 6.1 shkronjat a, b, c, d (reputacioni i mirë, kompetenca profesionale, gjendje e përshtatshme financiare dhe zotërimi i mjeteve të transportit rrugor me motor, në numrin dhe gjendjen teknike të kërkuar).

7.2.2 Subjekti që kërkon të autorizohet nuk plotëson kërkesat specifike të linjës së rregullt të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve.

7.2.3 Subjekti që kërkon të licencohet/autorizohet ka paraqitur informacion jokorrekt në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës/autorizimit.

7.2.4 Subjekti që kërkon të rilicencohet/riautorizohet nuk plotëson kushtet për rinovimin e licencës/autorizimit, të përcaktuara me këtë udhëzim.

7.2.5 Provohet se shërbimi i kërkuar nga aplikanti do të influencojë drejtpërdrejt në të ardhurat e një shërbimi të rregullt tashmë të autorizuar.

7.2.6 Provohet se shërbimi i kërkuar nga aplikanti do të influencojë drejtpërdrejt në të ardhurat e shërbimit hekurudhor.

7.3 Pezullimi i licencës dhe lejes së transportit (autorizimit). Autoriteti kompetent që e ka lëshuar licencën/autorizimin mund ta pezullojë atë, duke ndërprerë për një periudhë të caktuar kohe veprimtarinë për të cilën është lëshuar licenca/autorizimi, në rastet kur:

7.3.1 kjo kërkohet me vendim gjykatë, deri në marrjen e vendimit përfundimtar;

7.3.2 ka njoftime të besueshme që vazhdimi i veprimtarisë mund të cenojë sigurinë rrugore të njerëzve, pronës, mjedisit dhe/ose marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë. Pezullimi zgjat deri në verifikimin dhe vendimin përfundimtar.

7.4 Heqja e licencës dhe e autorizimit. Licenca/autorizimi hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, kur:

7.4.1 Subjekti transportues i licencuar nuk i plotëson më kushtet e kreu III pika 6.1 shkronjat a, b, c, d, (reputacioni i mirë, kompetenca profesionale, gjendje e përshtatshme financiare dhe zotërimi i mjeteve të transportit rrugor me motor, në numrin dhe gjendjen teknike të kërkuar):

a) Subjekti transportues nuk plotëson më kushtin e pikës 6.1 shkronja “b” (gjendjen e përshtatshme financiare), atij i jepet deri 3 muaj kohë për të paraqitur një plan biznesi, që të vërtetojë se gjendja e tij financiare, në të ardhmen, do të jetë e mirë;

b) Subjekti transportues nuk plotëson më kushtin e pikës 6.1 shkronja “c” (kompetencën profesionale), atij i jepet deri 3 muaj kohë, për zëvendësimin dhe emërimin e personave të tjerë. Në rastin kur sipërmarrësi kryen transport mallrash të rrezikshme, kjo periudhë kohe nuk duhet të jetë më e madhe se 30 ditë.

7.4.2 Subjekti transportues e transferon licencën/autorizimin e tij tek një tjetër.

7.4.3 Subjekti i autorizuar për shërbim transporti ndërkombëtar udhëtarësh në linjë të rregullt kryen shkelje të rënda e të përsëritura në lidhje me kushtet e përshkruara në autorizim për itinerarin, vendqëndrimet, frekuencën dhe oraret.

7.4.4 Subjekti transportues kryen shkelje të rënda e të përsëritura në lidhje me sigurinë rrugore, gjendjen teknike të automjetit, orëve të punës dhe pushimit të drejtuesve të automjetit, si edhe të kushteve që janë përshkruar në licencë.

7.4.5 Subjekti transportues, në shërbimet në linjë të rregullt të udhëtarëve, nuk fillon veprimtarinë brenda 60 ditëve nga data e marrjes së licencës ose ndërpret veprimtarinë për më shumë se 45 ditë, në transportin e brendshëm dhe 30 ditë në transportin ndërkombëtar.

7.4.6 Subjekti transportues përdor autorizim ose certifikatë të falsifikuar.

7.4.7 Provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës/autorizimit.

7.4.8 Licencat e ECMTCEMT-it hiqen edhe në rastet e përdorimit të pamjaftueshëm të tyre ose të kufizuar vetëm në transportet dypalëshe (bilaterale).

8. Pavlefshmëria dhe zëvendësimi i licencave, lejeve të transportit (autorizimeve) dhe certifikatave

8.1 Licenca, autorizimi dhe certifikata është e pavlefshme kur:

8.1.1 I ka përfunduar afati i vlefshmërisë.

8.1.2 Në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:

- a) emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;
- b) nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;
- c) data e fillimit dhe e mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.

8.2 Zëvendësimi i licencës, autorizimit dhe/ose certifikatës bëhet me kërkesë të titullarit të saj për rastet kur deklarohet e humbur, e vjedhur, e shkatërruar ose kur ka humbur vlefshmërinë sipas pikës 8.1.2 më sipër. Autoriteti kompetent që ka lëshuar licencën, autorizimin dhe/ose certifikatën njofton për verifikim organet e kontrollit.

8.3 Subjektit të transportit që kërkon zëvendësimin e licencës, lejes së transportit (autorizimit) dhe/ose certifikatës, sipas pikës 8.2, i jepet një autorizim i përkohshëm njëmuor nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, për vazhdimin e veprimtarisë deri në kryerjen e verifikimeve të nevojshme.

8.4 Pas kryerjes së verifikimeve, lëshohet një licencë, autorizim ose certifikatë zëvendësuese me të njëjtën përmbajtje, me përjashtim të numrit të identifikimit që do të jetë i ndryshëm.

8.5 Autorizimi i përkohshëm njëmuor për vazhdimin e veprimtarisë jepet nga autoriteti kompetent që i ka lëshuar ato, edhe për rastet e rinovimit të licencës, lejes së transportit (autorizimit) ose certifikatës, kur vonesat në rinovim, që nuk janë përgjegjësi e aplikantit, rrezikojnë ndërprerjen e veprimtarisë. Autorizimi lëshohet vetëm kur automjetet kanë certifikatë të vlefshme të kryerjes së kontrollit teknik të tyre.

9. Periudha e vlefshmërisë së licencës, autorizimit dhe certifikatës

9.1 Licenca/autorizimi lëshohet me periudhë vlefshmërie njëvjeçare për vitin e parë të licencimit/autorizimit dhe deri në tre vjet, për rinovim licence/autorizimi, kur subjekti ka ushtruar me korrektësi veprimtarinë për të cilën është licencuar/autorizuar.

9.2 Autorizimi që i jepet subjektit nga autoriteti kompetent për territorin për t'u licencuar në transport ndërqytetës udhëtarësh në linjë të rregullt, ka një periudhë vlefshmërie 60 ditore deri në datën e dorëzimit të dokumentacionit në zyrën përkatëse të licencave. Në autorizim nuk përcaktohet periudha e vlefshmërisë së licencës, e cila është kompetencë e autoritetit që e lëshon atë.

9.3 Certifikata lëshohet me periudhë njëvjeçare vlefshmërie.

#### KREU IV

#### PROCEDURAT PËR LICENCIM, AUTORIZIM DHE CERTIFIKIM NË VEPRIMTARINË E TRANSPORTEVE RRUGORE

10. Kërkesat dhe dokumentacioni i personave fizikë dhe juridikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari transporti rrugor, dorëzohen në zyrën e licencave të transportit rrugor, të caktuara për këtë qëllim nga ministri ose autoriteti kompetent, në territorin ku ka selinë ose ushtron veprimtarinë subjekti.

11. Zyra e licencave të transportit pranon dokumentacionin nga subjektet aplikante, vetëm duke u bazuar në rregullshmërinë ligjore të dokumenteve në zbatim të këtij udhëzimi.

Dokumentacioni pranohet vetëm i dorëzuar nga personi fizik dhe, për rastet e personit juridik, nga administratori ose i autorizuari prej tyre me akt noterial.

Zyra e licencave të transportit ka të drejtën e komunikimit zyrtar me subjektin, për plotësimin e dokumentacionit e deri në marrjen e licencës, lejes, autorizimit, certifikatës.

Dokumentet e një subjekti quhen zyrtarisht të dorëzuara, duke filluar nga data që subjekti i ka plotësuar ato në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi dhe i ka protokolluar në zyrën e licencave të transportit. Zyra e licencave të transportit ka të drejtë të kërkojë dokumentacion plotësues për verifikim dhe jep të gjitha sqarimet e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm.

Data e lëshimit të licencës, lejes së transportit, lejes së operimit, autorizimit dhe/ose certifikatës është, data e dorëzimit në zyrën e licencave të nënshkruara nga ministri ose autoritetet e tjera kompetente, sipas kreut II pika 4 dhe 5.9.

12. Zyra e licencave të transportit përgatit materialin për dhënien e licencës, lejes së transportit, lejes së operimit dhe/ose certifikatës vetëm për ato subjekte, të cilat kanë plotësuar dokumentacionin sipas kërkesave të këtij udhëzimi. Materiali duhet të jetë i plotë dhe të pasqyrojë

me hollësi të gjitha elementet e nevojshme për dhënien e lejes për veprimtarinë përkatëse. Ky material shqyrtohet nga eprorët brenda drejtorisë dhe miratohet prej tyre.

Materiali i përgatitur për licencat kthehet në vendim, pasi miratohet nga ministri ose autoriteti kompetent për territorin. Vendimi bëhet në dy kopje.

13. Zyra e licencave të transportit, mbi bazën e vendimit, përgatit formatet sipas standardeve të miratuara. Këto licenca nënshkruhen nga ministri, personat e autorizuar prej tij ose nga autoriteti kompetent.

Licencat i dorëzohen subjektit nga zyra e licencave të transportit së bashku me dokumentet shoqëruese.

Certifikatat e mjeteve nënshkruhen nga Drejtori i Përgjithshëm i Transportit Tokësor në ministri dhe nga drejtori që mbulon veprimtarinë e transportit në qark/bashki/komunë.

Lejet (autorizimet) e transportit dhe lejet (autorizimet) e operimit në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, nënshkruhen nga Drejtori i Përgjithshëm i Transportit Tokësor në ministri.

Zyra e licencave arkivon praktikën në bazë të muajve të vitit kalendarik, duke mbajtur shënimet e plota të arkivimit dhe të dorëzimit të tyre, në një regjistër vjetor. Dokumentacioni ruhet në këtë zyrë për një periudhë trevjeçare dhe më pas dorëzohet në arkivin qendror të autoritetit kompetent.

14. Zyra e licencave, brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të dokumenteve, duhet t'i japë përgjigje subjektit për miratim ose jo të licencës/autorizimit.

Në rast se subjektit nuk i miratohet kërkesa për marrjen e licencës/autorizimit, atëherë atij i lind e drejta e ankesës sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

15. Licencat, lejet dhe të gjitha dokumentet për transport që emërtohen në zbatim të këtij udhëzimi, janë subjekt i pagesës në llogarinë e organit kompetent që i lëshon ato, në bazë të tarifave të miratuara.

Të ardhurat që grumbullohen nga lejet, shënohen në një regjistër të veçantë me të gjitha ekstremet e tyre. Këto të dhëna në fillim të muajit pasardhës i dorëzohen zyrës së llogarisë për të kryer rakordimet përkatëse.

16. Formatet e licencave, lejeve, autorizimeve dhe certifikatave për çdo veprimtari transporti janë dokumente standarde dhe miratohen nga ministria.

17. Dokumentet e paraqitura sipas kërkesave të këtij udhëzimi duhet të jenë origjinale ose kopje të noteruara.

## KREU V

### KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE NË FUSHAT E TRANSPORTIT RRUGOR

18. Dokumentacioni i përbashkët që kërkohet për çdo veprimtari në transportin rrugor.

18.1 Kërkesa e aplikantit, e cila duhet të përmbajë:

- a) llojin e veprimtarisë që kërkon të kryejë;
- b) adresën e plotë të selisë/filialit, numrin e telefonit dhe faksit;
- c) targat e automjeteve që do të përdorë, me përjashtim të kërkesave për agjenci dhe konsulencë.

18.2 Dëshmi penaliteti për administratorin e shoqërisë dhe kur kërkesa për kompetencë profesionale nuk plotësohet nga administratori ose pronari/pronarët e shoqërisë, edhe për drejtuesin teknik të veprimtarisë, i cili e plotëson këtë kërkesë.

Kjo dëshmi nuk kërkohet për veprimtarinë e transportit për llogari të vet.

18.3 Kontratën, me kohëzgjatje të paktën njëvjeçare me drejtuesin teknik të veprimtarisë, që plotëson kërkesën për kompetencë profesionale, për rastet kur kjo nuk plotësohet nga administratori ose pronari/pronarët e shoqërisë.

Kjo kontratë nuk kërkohet për veprimtarinë e transportit për llogari të vet.

18.4 Dokumenti që vërteton zotërimin e kompetencës profesionale, sipas pikës 6.4, kreu III, për pronarin/administratorin ose personin që drejton veprimtarinë e transportit që do të licencohet.

Ky dokument nuk kërkohet për veprimtarinë e transportit për llogari të vet.

18.5 Certifikata e kontrollit teknik vjetor (model 020/021) dhe leja e qarkullimit, për çdo automjet, me përjashtim të kërkesave për agjenci dhe konsulencë.

18.6 Përveç dokumentacionit të mësipërm subjekti paraqet edhe dokumentacionin si vijon:

18.6.1 Aplikim për herë të parë:

a) Akti i themelimit dhe statuti i personit juridik ose vendimi i regjistrimit në gjykatë.

b) Programi vjetor ekonomiko-financiar dhe i zhvillimit të veprimtarisë për biznesin që do të ushtrohet (planbiznesi).

Ky program nuk kërkohet për veprimtarinë e transportit për llogari të vet.

c) Sigurimin bankar ose garancinë e sigurimit, që vërteton gjendje të përshtatshme financiare, sipas kreut III pika 6.3.

Ky dokument nuk kërkohet për veprimtarinë e transportit për llogari të vet.

18.6.2 Aplikim për përsëritjen e veprimtarisë:

a) Vendimi i regjistrimit në gjykatë të personit fizik ose juridik.

b) Evidenca statistikore vjetore, sipas formularit të miratuar nga ministria.

Kjo evidencë nuk kërkohet për veprimtarinë e transportit për llogari të vet.

c) Raporti ekonomiko – financiar i veprimtarisë së një viti më parë.

Ky raport nuk kërkohet për veprimtarinë e transportit për llogari të vet.

d) Certifikata e regjistrimit në organin tatimor. Dokumenti i shlyerjes së detyrimit fiskal për vitin paraardhës në emër të shoqërisë ose të anëtarëve të saj.

e) Licencën/lejen/autorizimin/certifikatën për të cilat kërkohet rinovimi.

Dokumentet për rinovimin e licencave, lejeve, autorizimeve, certifikatave, kërkesat për shtyrjen e afatit të lejeve të operimit për territoret e shteteve të tjera, paraqiten mbi 30 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

19. Dokumentacioni dhe kërkesat e veçanta sipas llojit të veprimtarisë në transportin rrugor

Përveç dokumentacionit të përbashkët sipas pikës 18 më sipër, aplikantët për ushtrim veprimtarie në fushën e transportit rrugor, duhet të paraqesin edhe dokumentacionin sipas kërkesave të veçanta për çdo lloj veprimtarie dhe të ndjekin procedurat përkatëse si vijon.

#### **I. TRANSPORT RRUGOR UDHËTARËSH BRENDË VENDIT**

19.1 Procedurat për lëshimin e autorizimit të bashkisë për operim në linjë të rregullt transporti udhëtarësh me autobus.

19.1.1 Autorizimi nga bashkia e qytetit ku fillon linja është e drejta që i jepet një subjekti juridik transporti për të operuar në një linjë ndërqytetëse.

Autorizimi lëshohet vetëm për linjat e miratuara nga ministri/kryetari këshillit të qarkut në rrjetin e linjave të transportit ndërqytetës të udhëtarëve.

19.1.2 Autorizimi lëshohet vetëm për operim në linja të reja ose për linja ku nuk operohet më, për shkak të heqjes ose anulimit të licencës subjektit të licencuar më parë.

19.1.3 Bashkia e qytetit, nëpërmjet një komisioni vlerësues të emëruar nga kryetari i bashkisë, përzgjedh me konkurs të hapur subjektin juridik, i cili do të quhet kandidat për të operuar në një linjë të caktuar të rregullt udhëtarësh.

Përzgjedhja kryhet mbi bazën e plotësimit më të mirë të kriterëve bazë të përshtatshmërisë financiare, kompetencës profesionale dhe numrit e gjendjes teknike të autobusëve, sipas kreut III pika 6.

19.1.4 Në bazë të vendimit të komisionit vlerësues, kryetari i bashkisë lëshon autorizimin për subjektin e transportit të përzgjedhur si kandidat për të operuar në linjë të rregullt udhëtarësh.

Në autorizim duhet të shënohet:

a) emri i subjektit, selia e tij,

b) emërtimi i linjës ndërqytetëse,

c) orarët e nisjes, duke respektuar numrin e orarëve të miratuar nga ministria,

d) targat e autobusëve me të cilët është fituar konkursi dhe që do të operojnë në këtë linjë.

Gjatë ushtrimit të mëtejshëm të veprimtarisë, subjekti transportues mund të ndërrojë e rifreskojë inventarin e autobusëve që operojnë në linjë, por gjithnjë brenda kriterit të numrit, moshës dhe gjendjes teknike të tyre.

19.1.5 Gjatë monitorimit të veprimtarisë së subjektit të autorizuar prej saj, bashkia mund të kërkojë pezullimin ose heqjen e licencës, nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, për rastet e parashikuara në kreun III pikat 7.3 dhe 7.4.

19.1.6 Për efekt të rinovimit të licencës dhe me kërkesë të subjektit të transportit, bashkia lëshon një vërtetim për plotësim të kushteve të autorizimit përkatës, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së transportit të udhëtarëve në linjë të rregullt me autobus, për periudhën për të cilën ishte licencuar.

19.2 Vërtetimi i miratimit të orarit të kthimit nga bashkia të stacionit fundor të linjës.

19.2.1 Bashkia e stacionit fundor të linjës është e detyruar të miratojë orarë të përshtatshëm të kthimit për subjektet e bashkive ku fillon linja, brenda një afati prej 15 ditësh nga paraqitja e kërkesës.

Në rast të kundërt, autoriteti kompetent për lëshimin e licencës, për territorin ku ka selinë subjekti, përcakton me vendim orarin e kthimit, duke njoftuar bashkinë përkatëse për zbatimin e tij.

19.2.2 Mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga bashkia ku fillon linja ose vërtetimit sipas pikës 19.1.6 dhe pasi subjekti të paraqesë kontratën me agjencinë e udhëtarëve në stacionin fundor, bashkia e këtij stacioni lëshon përkatësisht vërtetim ose konfirmim për miratimin e orarit të kthimit në përshtatje me kërkesën për transport të udhëtarëve.

19.3 Transporti qytetës

Licenca për këtë veprimtari lëshohet vetëm për subjekte juridike brenda rrjetit të linjave që këshilli i bashkisë i përcakton me vendim të veçantë. Për përzgjedhjen e subjektit transportues do të përdoren kriteret bazë të licencimit sipas kreut III.

19.4 Transporti rrethqytetës

Rrjeti i linjave rrethqytetëse dhe orari e tyre miratohen nga këshilli i qarkut, duke pasur parasysh kërkesën për transport të udhëtarëve.

Subjekti duhet të paraqesë kontratën me një agjenci për udhëtarë brenda vendit, në bashkinë/komunën ku fillon linja, si dhe vërtetimin e miratimit të orarit të kthimit nga bashkia/komuna e stacionit fundor të linjës.

Bashkia/komuna e stacionit fundor të linjës është e detyruar të caktojë orarë të përshtatshëm për subjektin transportues të bashkisë, komunës ku fillon linja.

19.5 Transporti ndërqytetës i udhëtarëve me autobus

19.5.1 Licenca për transportin ndërqytetës u lëshohet vetëm personave juridikë.

19.5.2 Rrjeti i linjave midis bashkive të qarqeve të ndryshme dhe numri i orarëve, miratohet nga ministri.

19.5.3 Rrjeti i linjave midis bashkive qendër të rretheve të ndryshme brenda një qarku dhe numri i orarëve miratohet nga këshilli i qarkut.

19.5.4 Subjekti paraqet:

a) Autorizimin nga bashkia e qytetit ku fillon linja.

b) Licencën e subjektit për agjenci udhëtarësh ose kontratën me një agjenci tjetër të licencuar të qytetit ku fillon linja.

c) Vërtetimin e miratimit të orarit të kthimit nga bashkia të stacionit fundor të linjës.

19.5.5 Për rinovimin e licencës subjekti transportues duhet të paraqesë:

a) Vërtetimin e bashkisë sipas pikës 19.1.6 dhe miratimin e orarit të nisjes për linjat që mbulon subjekti.

b) Vërtetimin nga bashkia të stacionit fundor të linjës për miratimin e orarit të kthimit.

c) Licencën e subjektit për agjenci udhëtarësh ose kontratën me një agjenci tjetër të licencuar të qytetit ku fillon linja.

19.6 Transporti i udhëtarëve me taksi

Licenca për këtë veprimtari lëshohet për persona fizikë dhe juridikë.

Subjekti paraqet:

- a) Aktin e vlerësimit të automjetit për transport udhëtarësh taksi.
- b) Dëshminë e aftësisë profesionale të taksistit.
- c) Dokumentin nga organi kompetent për vendosjen, kolaudimin dhe plumbosjen e taksimetrit.

Për rinovimin e licencës nuk ka kërkesa të veçanta.

19.7 Veprimtari agjenci transporti udhëtarësh e taksi brenda vendit

Licenca për ushtrimin e kësaj veprimtarie u lëshohet personave fizikë ose juridikë.

Subjekti paraqet dokumentin e pronësisë ose qiramarrjes mbi zyrën/zyrat e agjencisë. Zyra/zyrat duhet të ndodhen në vend të përshtatshëm për t'u shërbyer udhëtarëve.

Për rinovimin e licencës nuk ka kërkesa të veçanta.

## II. TRANSPORT NDËRKOMBËTAR UDHËTARËSH ME AUTOBUS

19.8 Transport ndërkombëtar udhëtarësh me autobus

19.8.1 Licenca për ushtrim veprimtarie në transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus lëshohet vetëm për persona juridikë të organizuar në shoqëri transporti. Në objektin e veprimtarisë të personit juridik duhet të jetë transporti ndërkombëtar i udhëtarëve.

19.8.2 Subjekti i transportit që aplikon për këtë licencë paraqet:

a) Dokumente që vërtetojnë se subjekti ka eksperiencë mbi tre vjet në transport udhëtarësh. Kjo eksperiencë e subjektit vërtetohet me eksperiencën e pronarit/pronarëve, administratorit ose e drejtuesit teknik të veprimtarisë me të cilin ka një kontratë pune me afat jo më pak se një vit.

b) Dokument që vërteton se subjekti zotëron si pronë ose të huazuar me kontratë qiramarrje, huapërdorje ose blerje me këste, me afat jo më pak se një vit, të paktën një autobus të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve. Këta autobusë nuk duhet të jenë të certifikuar në këtë periudhë për subjekte të tjera të transportit ndërkombëtar.

Për rinovimin e licencës kërkohet vetëm dokumenti i shkronjës “b” më sipër.

19.8.3 Kjo licencë, kur nuk është e shoqëruar nga një leje (autorizim) transporti ndërkombëtar për operim në linjë të rregullt (pika 2.23.4) ose për transport të rregullt të specializuar (pika 2.23.5), ose transport lavjerrës (pika 2.24), i jep subjektit të drejtën për të ushtruar veprimtari transporti ndërkombëtar udhëtarësh me autobus vetëm për shërbime të rastit, sipas kreut I pika 2.25.

19.9 Transport ndërkombëtar udhëtarësh të rregullt ose lavjerrës.

Për të ushtruar shërbimin e transportit ndërkombëtar të rregullt të udhëtarëve, sipas kreut I, pika 2.23 dhe lavjerrës, sipas pikës 2.24, ministria (Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Tokësor) lëshon lejen e transportit (autorizimin) për operimin në një linjë të rregullt të caktuar, në transportin e rregullt të specializuar ose në shërbimin lavjerrës.

Ky autorizim u lëshohet vetëm subjekteve të licencuara për transport ndërkombëtar udhëtarësh sipas pikës 19.8 më sipër.

19.9.1 Leje transporti (autorizim) për të operuar në një linjë të rregullt ndërkombëtare transporti me autobus

19.9.1.1 Autorizimi lëshohet për linja të rregullta ndërkombëtare të miratuara nga autoritetet kompetente, palë në një marrëveshje bilaterale për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve. Miratimi i linjës nënkupton miratimin e itinerarit, vendqëndrimeve, frekuencës javore të udhëtimeve dhe kushte të tjera për operim.

19.9.1.2 Kur sipas marrëveshjeve bilaterale për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve shërbimi në linjë të rregullt është i liberalizuar tërësisht, linja propozohet nga subjekti aplikues për autorizim dhe miratohet nga ministria (Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Tokësor) në bazë të kërkesës për transport.

19.9.1.3 Subjekti i transportit paraqet:

a) Licencën e agjencisë për transport ndërkombëtar udhëtarësh, kur është i licencuar për këtë veprimtari agjencie ose kontratën për shërbim agjencie me një subjekt që është i licencuar për agjenci për transport ndërkombëtar udhëtarësh.

b) Dokumentin që vërteton se subjekti zotëron si pronë ose të huazuar nëpërmjet një kontrate qiramarrjeje, huapërdorjeje ose blerjeje me këste, me afat jo më pak se një vit, numrin e nevojshëm të autobusëve të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve. Këta autobusë nuk duhet të jenë të certifikuar në këtë periudhë për subjekte të tjera të transportit ndërkombëtar në linjë të rregullt.

c) Kontratën e partneritetit për operimin në linjë të rregullt ose shërbim agjencie me një subjekt transportues ose agjenci të shtetit tjetër, të licencuar ose të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi të atij shteti.

d) Hartën me itinerarin dhe vendqëndrimet e linjës.

e) Grafikonin e linjës me ditët dhe orarin e nisjes dhe të mbërritjes.

f) Projekti i tarifave të biletave.

g) Planbiznesin për linjën që kërkohet të operohet.

19.9.1.4 Autorizimi për shërbimin në linjë të rregullt, i shkruar dhe i plotësuar në gjuhën shqipe dhe angleze, përmban:

- numrin e identifikimit,
- emrin e plotë dhe adresën e subjektit transportues,
- datën e lëshimit të autorizimit dhe datën e mbarimit të periudhës së vlefshmërisë,
- itinerarin e linjës dhe vendqëndrimet për marrjen dhe lënien-udhëtarëve,
- frekuencën javore të operimit në linjë,
- kushtet dhe kërkesa të tjera specifike për operimin në linjë të rregullt.

Dokumentacioni sipas shkronjave "d", "e" dhe "f" më sipër, përbën anekset e kontratës sipas shkronjës "c".

19.9.1.5 Për rinovim të autorizimit, subjekti paraqet dokumentet brenda periudhës së vlefshmërisë, sipas shkronjave "a" dhe "c" më sipër.

19.9.1.6 Për rastet e zgjatimit të linjave të rregullta të transportit të udhëtarëve me autobus, që kryhen mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare, autorizimi i lëshuar ndaj subjektit që operon në linjë është i vlefshëm dhe ka të njëjtën periudhë vlefshmërie edhe për zgjatimin e linjës.

19.9.2 Leje operimi (autorizim) për subjektet e huaja të transportit për të operuar në një linjë të rregullt ndërkombëtare transporti me autobus.

19.9.2.1 Pas lëshimit të autorizimit për shërbim në linjë të rregullt udhëtarësh, subjektit të transportit të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, në bazë të parimit të reciprocitetit, i lëshohet dhe autorizimi (leja e operimit) për operim në territorin shqiptar ose për transitim për subjektin e shtetit tjetër, palë në marrëveshjen bilaterale, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti ose të kontratave të partneritetit apo të shërbimit agjenci.

19.9.2.2 Njëkohësisht, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Tokësor në ministri i kërkon autoritetit kompetent të shtetit tjetër lëshimin e autorizimit për subjektin shqiptar për të operuar ose transituar në territorin e atij shteti.

19.9.2.3 Për nxjerrjen e autorizimit për territoret e vendeve ku kalon linja transit ose ku përfundon linja, subjekti transportues paraqet kërkesën, së bashku me katër kopjet e anekseve të kontratës, 30 ditë përpara përfundimit të afatit të autorizimit ekzistues.

19.9.3 Leje transporti (autorizim) për shërbim ndërkombëtar transporti të rregullt të specializuar ose lavjerrës.

19.9.3.1 Autorizimi për shërbimet e rregullta të specializuara ose lavjerrës u lëshohet vetëm subjekteve juridike të licencuara për transport ndërkombëtar udhëtarësh ose subjekteve transportuese të udhëtarëve për llogari të vet, që kërkojnë të kryejnë shërbime të rregullta të specializuara sipas kreut I pika 2.23.5.

19.9.3.2 Për pajisjen me autorizim subjekti paraqet:

a) Licencën për transport ndërkombëtar udhëtarësh ose dokumentin që vërteton se shërbimi i rregullt i specializuar do të kryhet për llogari të vet.

b) Kontratën me subjektin për të cilin kryhet shërbimi i rregullt i specializuar ose lavjerrës, kur këtë shërbim nuk e kryen vetë subjekti për llogari të vet.

c) Dokumentin që vërteton se subjekti zotëron si pronë ose të huazuar nëpërmjet një kontrate qiramarrjeje, huapërdorjeje ose blerjeje me këste, me afat jo më pak se një vit, numrin e nevojshëm të autobusëve të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.

d) Itinerarin e linjës, vendqëndrimet dhe frekuencën e udhëtimeve.

19.9.3.3 Pas pranimit të dokumentacionit të mësipërm, ministria (Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Tokësor) i lëshon subjektit transportues autorizimin përkatës për shërbime të rregullta të specializuara ose lavjerrës.

Autorizimi përmban të njëjtat të dhëna sikurse dhe autorizimi që lëshohet sipas pikës 19.9.1.

19.9.3.4 Njëkohësisht, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Tokësor i kërkon autoritetit kompetent të shtetit tjetër, palë në marrëveshjen e transportit rrugor, lëshimin e autorizimit për subjektin shqiptar për të operuar ose transituat në territorin e atij shteti.

19.9.3.5 Për rinovimin e autorizimit nuk ka kërkesa të veçanta.

19.9.4 Leje transporti (autorizim) për shërbim transporti ndërkombëtar të rastit me autobus

19.9.4.1 Autorizimi për shërbim të rastit, sipas kreut I pika 2.25 lëshohet për subjektet e licencuara për transport ndërkombëtar udhëtarësh, sipas pikës 19.8 më sipër, për subjektet që kryejnë transport ndërkombëtar udhëtarësh për llogari të vet, sipas kreut I pika 2.26 dhe për agjencitë turistike të licencuara nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit.

19.9.4.2 Në varësi të marrëveshjes bilaterale për transportin ndërkombëtar rrugor me shtetin destinacion të udhëtimit ose të transitimit, subjektet pajisen me autorizime (leje bilaterale transporti) që lëshohen nga ministria (Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Tokësor) ose nga ANALTIR.

19.9.4.3 Për marrjen e autorizimit/lejes bilaterale subjekti paraqet:

a) Licencën për transport ndërkombëtar udhëtarësh ose për agjenci turistike ose dokumentin që vërteton se shërbimi i rastit do të kryhet për llogari të vet.

b) Kontratën me subjektin për të cilin kryhet shërbimi i rastit, kur këtë shërbim nuk e kryen vetë subjekti për llogari të vet.

c) Dokumentin që vërteton se subjekti zotëron si pronë ose të huazuar nëpërmjet një kontrate qiramarrjeje, huapërdorjeje ose blerjeje me këste, me afat jo më pak se një vit, autobus të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.

d) Certifikatën e autobusit model 021 ose certifikatën e lëshuar nga ministria për transport ndërkombëtar udhëtarësh.

e) Itinerarin e udhëtimit, vendqëndrimet dhe pikat e kalimit kufitar.

f) Emrin/mbiemrin e drejtuesit të grupit dhe të drejtuesit/drejtuesve të autobusit.

19.9.4.4 Autorizimi lëshohet vetëm për një udhëtim. Pas përfundimit të udhëtimit subjekti transportues e kthen autorizimin e përdorur tek autoriteti që e ka lëshuar.

19.10 Veprimtari agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh

19.10.1 Licenca për ushtrimin e kësaj veprimtarie u lëshohet vetëm personave juridikë.

19.10.2 Subjekti paraqet:

a) Dokumentin e pronësisë ose qiramarrjes mbi zyrën/zyrat e agjencisë.

b) Të paktën një kontratë me një transportues ndërkombëtar udhëtarësh. Kur subjekti është transportues, paraqet licencën për transport ndërkombëtar udhëtarësh.

19.10.3 Subjekti i pajisur me licencë për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh mund të ushtrojë edhe veprimtarinë e agjencisë për transport të brendshëm udhëtarësh, kur zyra/zyrat e tij janë në vend të përshtatshëm për shërbim agjencie ndaj këtij transporti.

19.10.4 Për rinovimin e licencës nuk ka kërkesa të veçanta.

### III. TRANSPORT RRUGOR MALLRASH

19.11 Përjashtime nga sistemi i licencimit dhe certifikimit

19.11.1 Transporti i mallrave me mjete rrugore me motor me kapacitet transportues nën 500 kg nuk është subjekt licencimi apo certifikimi.

19.11.2 Mjetet e transportit rrugor të mallrave me kapacitet transportues nën 0.8 ton nuk certifikohen për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vet.

19.11.3 Mjetet e transportit rrugor të mallrave me kapacitet transportues nën 3.5 ton nuk certifikohen për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë e me qira.

19.11.4 Nuk është subjekt licencimi transporti i mallrave për të tretë dhe me qira me mjetet rrugore me motor:

a) të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

b) të Kryqit të Kuq, Gjysmëhënës së Kuqe dhe ato mjete që transportojnë ndihma ushqimore e mjekësore në rastet e fatkeqësive natyrore,

c) që transportojnë mallrat e rastit për ose nga aeroportet,

d) të transportit të kafshëve të gjalla me automjete të specializuara për këtë qëllim,

e) që transportojnë pjesë këmbimi për mjetet e difektuara në rrugë, për anije ose për aeroplanë,

f) që shkojnë për të zëvendësuar një mjet të difektuar në rrugë,

g) që transportojnë objekte ose materiale për shfaqje teatrale, sportive, cirku, për regjistrime në radio, në televizion dhe për prodhime filmike,

h) të funeraleve,

i) të Bankës së Shtetit,

j) të pastrimit të kanaleve të ujërave të zeza,

k) të transportit të ujit të pijshëm,

l) të autoriteteve lokale për mbrojtjen civile (MCR), të policisë, të zjarrfikësve, autoambulancat avaro-shpëtuese të minierave,

m) të urgjencës së elektrikut, ujit të pijshëm, telekomit, të aeroporteve brenda tyre,

n) të provës nga prodhuesi,

o) të pastrimit të borës dhe shpërndarjes së kripës dhe të rërës në rrugë,

p) që lëvizin me avull ose energji elektrike, të pajisur me mekanizma ngarkim-shkarkimi, gjysmërimorkio ose rimorkio që nuk shërbejnë për transport mallrash, por që lidhen me konstruksionin e mjeteve për mirëmbajtjen e rrugëve, rulet rrugorë dhe rimorkiot e tyre.

19.11.5 Nuk është subjekt certifikimi transporti rrugor për llogari të vet i mallrave:

a) Që transportohen me mjete që përfshihen në pikën 19.11.4, kur ato punojnë për llogari të vet.

b) Mbeturinave që dalin nga pastrimi i qyteteve dhe shërbimeve të tjera publike në qytete.

c) Çimento rifuzo nga fabrika për në objektet e ndërtimit.

d) Të furnizimit të njësive tregtare me vezë, peshk të freskët, perime të freskëta, qumësht e prodhime të tij, kur ato ndodhen brenda qytetit.

e) Të furnizimit të farmacive ose spitaleve me barna mjekësore brenda qytetit.

f) Postës, kur mjetet janë pronë e Drejtorisë së Përgjithshme të Postave.

g) Prodhimeve nga feramat bujqësore e blegtorale për në fabrikat e përpunimit.

h) Orendive, mobiljeve dhe sendeve të tjera shtëpiake si dhe orendi e pajisje zyra.

i) Sendeve ose lëndëve të konsumit publik, si libra, pajisje shkollash, spitalesh ose qendrash shëndetësore, ato të qendrave kërkimore-shkencore.

j) Sendeve dhe lëndëve të forcave të armatosura.

#### IV.1 TRANSPORT RRUGOR MALLRASH BRENDË VENDIT

19.12 Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira brenda vendit

Licenca për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit lëshohet për subjekte fizike dhe juridike.

Kjo licencë vlen edhe për transportin e mallrave për llogari të vet brenda vendit.

Për rinovim licence nuk ka kërkesa të veçanta.

19.13 Transporti i mallrave për llogari të vet brenda vendit

Veprimtaria e transportit të mallrave për llogari të vet brenda vendit, ushtrohet kundrejt certifikatës.

Kjo certifikatë lëshohet për subjekte fizike ose juridike.

Për rinovimin e certifikatës nuk ka kërkesa të veçanta.

#### 19.14 Transporti i mallrave të rrezikshme brenda vendit

Veprimtaria e transportit të mallrave të rrezikshme brenda vendit ushtrohet kundrejt certifikatës së mallrave të rrezikshme.

Kjo certifikatë lëshohet për çdo subjekt fizik ose juridik që kërkon të kryejë transport mallrash të rrezikshme brenda vendit. Subjekti paraqet:

- a) Certifikatën e kontrollit të çisternës për transportin e mallrave të rrezikshme (Model 013).
- b) Dëshminë e kualifikimit për drejtuesin e mjetit (Model 015)

Subjekti i pajisur me certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme nuk ka nevojë të pajiset me certifikatën sipas pikës 19.13 më sipër.

Për rinovimin e certifikatës për transport mallrash të rrezikshme, nuk ka kërkesa të veçanta.

#### IV.2 TRANSPORT NDËRKOMBËTAR RRUGOR MALLRASH

#### 19.15 Transporti ndërkombëtar i mallrave për të tretë dhe me qira

Licenca për këtë veprimtari u lëshohet vetëm personave juridikë, të cilët disponojnë jo më pak se 60 ton kapacitet transportues dhe/ose tërheqës.

Licencën për transportin ndërkombëtar të mallrave për të tretë mund ta fitojë edhe çdo subjekt juridik, i cili duke plotësuar kushtet e mësipërme, kryen veprimtarinë e transportit krahas veprimtarive të tjera për të cilat është licencuar, qoftë edhe për një pjesë të automjeteve që disponon.

Licenca për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira jep edhe të drejtën për transport mallrash brenda vendit për të tretë e me qira.

Kur subjekti kërkon leje për transporte të specializuara me automjete të specializuara, hiqet kushti i kapacitetit transportues mbi 60 ton, si më sipër.

Transporti i specializuar konsiderohet transporti i mishit, prodhimeve të freskëta të detit, transporti i makinerive dhe i peshave të rënda në platforma, transporti i veturave në platforma të posaçme, transporti i mallrave të rrezikshme etj.

Në kuptimin e mjeteve të specializuara për zbatimin e këtij paragrafi, kategorizohen automjetet termose dhe frigoriferike, tërheqëse dhe platformat e mëdha transportuese, tërheqëse dhe platformat e transportit të veturave etj.

Personat juridikë paraqesin vërtetimin e regjistrimit në shoqatën shqiptare të transportuesve ndërkombëtarë rrugorë ANALTIR.

Për mjetet që kryejnë transport ndërkombëtar mallrash të rrezikshme duhet të paraqesin edhe:

- a) Certifikatën e kontrollit të çisternës për transportin e mallrave të rrezikshme (Model 013).
- b) Dëshminë e kualifikimit për drejtuesin e mjetit (Model 015).

Për rinovimin e licencës për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira nuk ka kërkesa të veçanta.

#### 19.16 Transporti ndërkombëtar i mallrave për llogari të vet

Veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet ushtrohet kundrejt certifikatës. Kjo certifikatë lëshohet për subjekte fizike ose juridike.

Subjekti paraqet vërtetimin e regjistrimit në shoqatën e transportuesve ndërkombëtarë ANALTIR.

Për rinovimin e certifikatës për transport mallrash për llogari të vet, nuk ka kërkesa të veçanta.

#### 19.17 Transporti ndërkombëtar i mallrave të rrezikshme për llogari të vet

Kjo certifikatë lëshohet për çdo subjekt fizik ose juridik që kërkon të kryejë transport ndërkombëtar mallrash të rrezikshme. Subjekti, përveç dokumenteve sipas pikës 19.16, paraqet edhe:

- a) Certifikatën e kontrollit të çisternës për transportin e mallrave të rrezikshme (Model 013).
- b) Dëshminë e kualifikimit për drejtuesin e mjetit (Model 015).

Subjekti i pajisur me certifikatën për transportin e mallrave të rrezikshme nuk ka nevojë të pajiset me certifikatën sipas pikës 19.16 më sipër.

Për rinovimin e certifikatës për transport ndërkombëtar mallrash të rrezikshme nuk ka kërkesa të veçanta.

#### 19.18 Transport ndërkombëtar multilateral në vendet anëtare të ECMT/CEMT

Veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave ndërmjet dy a më shumë vendeve anëtare të ECMT/CEMT (Konferenca Europiane e Ministrave të Transportit) ushtrohet nga subjekte juridike të pajisura me leje (autorizim) multilaterale ECMT/CEMT.

Lejet multilaterale ECMT/CEMT u lëshohen vetëm subjekteve të licencuara për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira.

Subjekti paraqet:

- a) Licencën për transport ndërkombëtar të mallrave për të tretë dhe me qira.
- b) Certifikatën standard të kontrollit të gazeve dhe zhurmave për mjete euro 1, euro 2 dhe euro 3. Kjo certifikatë lëshohet nga prodhuesi i mjetit ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij në vendin e regjistrimit të mjetit.
- c) Certifikatën standard të sigurisë rrugore për mjetin me motor dhe për rimorkion ose gjysmërimorkion për mjete euro 2 dhe euro 3. Kjo certifikatë lëshohet nga prodhuesi i mjetit, nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij në vendin e regjistrimit të mjetit ose nga DPSHTRR.

Leja CEMT lëshohet bashkë me karnetën e rrugës. Karneta e rrugës përdoret për të kontrolluar përdorimin e lejes ECMT/CEMT. Ajo mbahet në mjet bashkë me lejen dhe ka të njëjtin numër me të.

Për të aplikuar sërish për leje ECMT/CEMT, subjekti transportues duhet të dorëzojë në zyrën e licencave, lejet e përdorura dhe karnetat e rrugës. Për lëshimin sërish të lejes ECMT/CEMT një subjekti, mbahet parasysh mënyra e përdorimit nga ana e tij të lejes paraardhëse.

Subjektet transportuese të cilat nuk e kanë përdorur lejen/lejet e ECMT/CEMT-it, janë të detyruara t'i kthejnë ato pranë zyrës së licencave. Në rast të kundërt, humbasin të drejtën për t'u pajisur përsëri me leje ECMT/CEMT, vitin pasardhës.

Leja/lejet ECMT/CEMT e anuluar ose të kthyerat të papërdorura nga një subjekt transportues, u jepen, për periudhën e mbetur të vlefshmërisë, subjekteve të tjera transportuese që kanë bërë kërkesë.

Leja ECMT/CEMT duhet të kthehet në zyrën e licencave brenda 15 ditëve pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

#### 19.19 Veprimtari agjenci spedicionere.

Licenca për veprimtari të agjencisë spedicionere u lëshohet vetëm personave juridikë.

Subjekti paraqet dokumentet e pronësisë mbi objektin e zyrës/zyrave ose kontratën e qiramarrjes.

Për rinovimin e licencës nuk ka kërkesa të veçanta.

#### 19.20 Konsulenca tekniko-ekonomike në veprimtaritë e transportit rrugor

Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së konsulencës tekniko-ekonomike në transportin rrugor u lëshohet personave fizikë dhe juridikë.

Konsulenca profesionale tekniko-ekonomike ushtrohet për:

- a) Njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor, sigurisë së qarkullimit, inspektimeve teknike.
- b) Menaxhim të qendrave të kontrollit dhe serviseve.
- c) Përcaktimin e kërkesave tekniko-ekonomike dhe prokurimin e blerjes së makinerive dhe pajisjeve për sektorë të ndryshëm të transportit.
- d) Përcaktimin e optimeve ekonomike në procesin e operimit në transportin e brendshëm dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave.
- e) Ekspertizë në vlerësimin e pasurive, llogaritjen e kostove operacionale dhe të drejtimit të veprimtarive të transportit rrugor.
- f) Ekspertizë në marrëdhëniet kontraktuale të fushave të transportit rrugor.
- g) Drejtimin teknik të veprimtarisë së transportit në një sipërmarrje transporti.
- h) Njohjen e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushat e transportit rrugor.

Subjekti mund të aplikojë për një ose më shumë nga fushat e mësipërme të konsulencës, të cilat shënohen edhe në licencë.

Personi fizik ose, kur aplikanti është person juridik, pronari/pronarët, administratori ose drejtuesi teknik, duhet të ketë mbaruar arsimin e lartë si inxhinier mekanik, ekonomist, financier ose jurist.

Për raste të veçanta pranohet diploma e mbarimit të arsimit të lartë edhe në fusha të tjera, kur subjekti vërteton me dokumente një eksperiencë pune më shumë se 10 vjet, në veprimtaritë për të cilat aplikon.

Subjekti paraqet:

- a) Një curriculum vitae (CV) të detajuar të tij.
  - b) Dokumente për vërtetimin e kualifikimeve dhe specializimeve të kryera.
  - c) Dokumente për vërtetimin e eksperiencës në punë për fushat e veprimtarisë ku aplikon.
  - d) Diplomën e mbarimit të shkollës së lartë.
  - e) Vërtetim për vjetërsinë e punës nga organi ku punon ose ka punuar për herë të fundit, si dhe për specialitetin ku ka punuar.
  - f) Dokumentin e pronësisë mbi zyrën ose kontratën e qiramarrjes.
- Për rinovim të licencës nuk ka kërkesa të veçanta.

## KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

20. Udhëzimi i ministrit nr. 142, datë 20.1.1998 “Për procedurat dhe kriteret që do të zbatohen për marrjen e lejeve për ushtrimin e veprimtarisë në fushat e transportit”, siç është ndryshuar, për dispozitat e veprimtarisë në transportin rrugor dhe të gjitha aktet e tjera të kësaj ministrie që bien ndesh me këtë udhëzim, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I TRANSPORTIT  
DHE I TELEKOMUNIKACIONIT  
**Spartak Poçi**

### **Ndreqje gabimi**

Në urdhrin nr.1, datë 13.1.2004 "Për miratimin e deklaratës së pasurisë dhe autorizimit përkatës", e cila është botuar në Fletoren Zyrtare nr.2 të janarit 2004, vetëm në faqen e parë (në kapakun e deklaratës) bëhet korrigjimi si vijon:

1. Formulari A6 të emërtohet: "Të ardhura personale nga paga, pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura".
  2. Formulari A7 të emërtohet: "Licenca dhe patentat që sjellin fitim".
  3. Formulari A8 të emërtohet: "Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë".
- Domethënë, zëvendësohet faqja 53 e Deklaratës me formatin e mëposhtëm.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**  
**Fatmira Laska**

**Inspektoriati i Lartë dhe Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive**  
Tel : 228-516, 228-527

**DEKLARATË**

Model 5.1

**PERSONIT QË MBART DETYRIM PËR DEKLARIM PASURIE**  
(Ligji 9049, datë 10/04/2003, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.31, Maj 2003)

**Per tu plotësuar nga Deklaruesi**

|      |         |              |                   |                   |                 |                 |
|------|---------|--------------|-------------------|-------------------|-----------------|-----------------|
| Emri | Mbiemri | Institucioni | Drejtoria/Sektori | Pozicioni/Titulli | Data e Emerimit | Data e Largimit |
|------|---------|--------------|-------------------|-------------------|-----------------|-----------------|

Data e dorëzimit të deklarates \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_  
Telefon / Cel. \_\_\_\_\_

1. Per here te pare ☐  
2. Vjetori ☐  
3. Me kerkese ☐  
4. Pas largimit nga funksioni ☐

Tipi i deklarimit: →

Numri total i faqeve te plotesuara nga une duke perfshire dhe  
kete faqe eshte: \_\_\_\_\_

**Vertetohet se deklarimet e bera nga une ne formularet bashkelidhur  
jane te plota, te verteta, te sakta dhe mbaj pergejteshi ligjore per  
saktesin e plotesimit te tyre**

**Deklaruesi**

Emer, Mbiemer, Nenshkrim

**Adresa e plote e banimit:**

**Permbledhje e Formulareve**

Formulari A-1 jo ☐ po ☐ - ne qofte se po ploteso kete formular bashkelidhur  
Pasuri te paluajtshme dhe e drejta reale mbi to  
Formulari A-2 jo ☐ po ☐ - ne qofte se po ploteso kete formular bashkelidhur  
Pasuri te luajtshme me regjistrim publike  
Formulari A-3 jo ☐ po ☐ - ne qofte se po ploteso kete formular bashkelidhur  
Sende me vlere mbi 5000 USD  
Formulari A-4 jo ☐ po ☐ - ne qofte se po ploteso kete formular bashkelidhur  
Aksione, letra me vlere, pjesë në kapitale  
Formulari A-5 jo ☐ po ☐ - ne qofte se po ploteso kete formular bashkelidhur  
Likuiditete (gjenje ne cash, ne llogari rryedhese, ne depozite, ne bono thesari dhe ne huadhenie)  
Formulari A-6 jo ☐ po ☐ - ne qofte se po ploteso kete formular bashkelidhur  
Te ardhura personale nga paga, pjesemarrja ne borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura  
Formulari A-7 jo ☐ po ☐ - ne qofte se po ploteso kete formular bashkelidhur  
Licenca dhe patentat që sjellin fitim  
Formulari A-8 jo ☐ po ☐ - ne qofte se po ploteso kete formular bashkelidhur  
Detyrime financiare ndaj personave juridik dhe fizike

**Per tu plotësuar nga Kontrolluesi**

Data e marrjes ne dorezim

\_\_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Emer, Mbiemer, Nenshkrim

Data e verifikimit

\_\_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

**Inspektori**

Emer, Mbiemer, Nenshkrim

(.....)

Nr. Indeksit (.....)

**Ne baze te verifikimeve te bera, deklarata rezultojn:**

1. E vertete ☐
2. Jo e vertete ☐
3. Me mangesi ☐

Komente te marresit ne dorezim te deklarates

Ne baze te informacionit qe permbahet ne kete raport,  
une konkludoj se **formalisht** deklarata eshte e plotësuar

1. Ne rregull dhe pranohet ☐
2. Jo ne rregull, kthehet per plotesim ☐

Komente te Inspektori:

### Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

|                                                   |
|---------------------------------------------------|
| LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004 |
|---------------------------------------------------|

|     |                                      |      |
|-----|--------------------------------------|------|
| 1.  | KUSHTETUTA                           | 600  |
| 2.  | KODI I PROCEDURËS CIVILE             | 500  |
| 3.  | KODI I PROCEDURËS PENALE             | 600  |
| 4.  | KODI PENAL                           | 400  |
| 5.  | KODI I PUNËS                         | 500  |
| 6.  | KODI I FAMILJES                      | 450  |
| 7.  | KODI CIVIL                           | 1000 |
| 8.  | KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN | 900  |
| 9.  | KODI ZGJEDHOR                        | 355  |
| 10. | DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR   | 1500 |

|                           |
|---------------------------|
| PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI |
|---------------------------|

|     |                                                            |      |
|-----|------------------------------------------------------------|------|
| 12. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT       | 800  |
| 13. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK | 1000 |

|                |
|----------------|
| BOTIME TË REJA |
|----------------|

|     |                                               |     |
|-----|-----------------------------------------------|-----|
| 14. | KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE             | 500 |
| 15. | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL | 600 |

*Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve*

Doli nga shtypi më 3.3.2004

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4500 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë